

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7727 E hënë 3 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Të hënën/të martën e kaluar, kalendarëve të shumtë në "Place de Luxembourg" përpara selisë së Parlamentit Evropian në Bruksel u binte në sy ...

Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Për diplomacinë kulturore në Bruksel



Intervista *e* **Ditës**

Zëri i Amerikës: Zoti Berisha! Këto ditë ka ndërruar jetë në SHBA presidenti amerikan Xhorxh Bush. Ju jeni ndër politikanët e pakët shqiptarë ...

Vijon në faqen 21

Nga ILIRIAN AGOLLI

"Bisedat e rralla me Bush", Berisha flet për mikun e shqiptarëve



"Në burg, kush është përfshirë në skemën korruptive"

Banorët e "Astirit" bllokojnë rrugën, Basha: Ka vepër penale, Marku poshtë 'tavolinës'

Unaza, kreu i PD: Zgjidhja, ndalimi i projektit dhe hetimi i plotë

Banorët e zonës së "Astirit" në Tiranë dolën sërish dhe në protestë për banesat që do të shemben nga projekti i Unazës së Re, duke bllokuar rrugën. Protestës së banorëve pasditen e djeshme iu bashkua edhe kreu i opozitës, Lulzim Basha, si mbështetje të opozitës në mbrojtje të banesave të tyre. Sipas tij, zgjidhja e situatës ...

Në faqen 3

RISHQYRTIMI NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE, ÇFARE DUHET TE DINI

PENSION I ULET, SI TE RRISNI MASEN E SI PLOTESOHET KERKESA

ISSH: Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët në "e-Albania": Mund të merrni pagesë më të lartë dhe zgjatje të afatit të përfitimit



(Në foto) Pensionistë (foto ilustruese)

FLASIN SHEHI E KRYEMADHI

Zgjedhjet, opozita cakton kandidatët, Aurel Bylykbashi: Do kandidoj për Elbasanin

Në faqen 2

SITUATA NE KU VEND

Amnistia në burgje rrezikon të dështojë, mazhoranca nuk i ka 84 votat që i duhen

Në faqen 4

HISTORIA E ZEFIT

U arratis bujshëm tri vite më parë, pranga të riut që kërkohet nga Italia

Në faqen 9

"ARTISTI I MERITUAR"

Kinematografia në zi, ndahet nga jeta aktori i mbi 90 roleve, Luan Qerimi

Në faqen 12

DRRASA: BIÇIKLETA SHKAKTON IMPOTENCE



Pelini i ëmbël shëron kancerin, këshillat e mjekut Merja për përdorimin

Suplement

Historia e panjohur e djaloshit kuksian nga radhët partizane, në Fakultetin e Mjekësisë

Fadil Spahiu, mjeku i diplomuar në Moskë, që vuajti burgjeve

Artikulli i gazetës "Pravda" për studentin shqiptar, që mahnti profesorët rusë

Nga DASHNOR KALOÇI

Fadil Spahiu është një nga ata dhjetëra shqiptarë që gjatë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës patën rastin të studioin në universitetet e vendeve të Europës Lindore, ku falë aftësiave të tij u diplomua me



EKSKLUZIVE

rezultate të shkëlqyera dhe për të shkruanin gazetat më të mëdha të Bashkimit Sovjetik të asaj kohe. Pas diplomimit, ai u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi punën plot pasion, duke endërruar që të bëhej një mjek i aftë dhe t'u shërbente bashkatdhetarëve ...

Në faqen 10-11

ZGJEDHJET OPOZITA

Kryemadhi: Po kërkojmë një kandidat të fortë për Tiranën. Shehi: Duhet njeri politik

Zgjedhjet, në janar opozita zgjedh kandidatët, Mediu: Jo të njëanshëm

Bylykbashi: Do kandidoj për Elbasanin

Valentina Madani

Opozita e bashkuar në muajin janar do të shpallë zyrtarisht listën e kandidatëve për drejtues të rinj të pushtetit lokal. Por, përgatitjet për zgjedhjet e ardhme lokale kanë nisur prej javësh ndërkohë që PD, e cila drejton aleancën e djathtë po shkon drejt zyrtarizimit të kandidaturës së parë. Bëhet fjalë për garën e Bashkisë së Elbasanit. Ish-deputeti i PD, Aurel Bylykbashi ka dhënë dorëheqjen nga drejtimi i degës së PD në Elbasan. Bylykbashi e njoftoi dorëheqjen paraditen e djeshme gjatë një fjalimi në Kuvendin e PD-së. Ish-deputeti falënderoi demokratët, ndërsa theksoi se është koha për një drejtim të ri të partisë. Bylykbashi mësohet se ka falënduar demokratët e Elbasanit për besimin e dhënë dhe ka theksuar se është koha për një drejtim të ri të partisë. Mësohet se Bylykbashi do të kandidojë për kryetar Bashkie në Elbasan në zgjedhjet e ardhshme, për këtë arsye është tërhequr nga drejtimi i demokratëve të Elbasanit. Në Elbasan, Eguen Isai u zgjodh kryetar i ri i Partisë Demokratike me 378 vota. Përballë tij garonte Zamir Muzhaqi, i cili fitoi vetëm 80 vota. Mësohet se vendimi i ish-deputetit Bylykbashi për t'u tërhequr nga drejtimi i PD në Elbasan lidhet me ambicën e tij për të garuar në zgjedhjet vendore për Bashkinë Elbasan. Gjithashtu, bëhet e ditur se prej disa muajsh Bylykbashi po punon me një staf të ngushtë për përgatitjen e fushatës. Sipas të njëjtave burime, mësohet se Bylykbashi do të kandidojë edhe nëse opozita nuk do të nominojë emrin e tij si kandidat.

ALEATËT

Me zgjedhjet elektorale në prag, për republikanët bashkimi i së djathtës është i rëndësishëm, ndërsa sa i takon përzgjedhjes së kandi-



Krerët e opozitës së bashkuar

MONIKA KRYEMADHI

"Ne jemi duke kërkuar për një kandidat shumë të fortë përballë Veliajt. Edi Rama do të kërcënohet politikisht për të kandiduar Veliajt. Nëse ai kandidon sërish për kryetar bashkie, shanset e Erion Veliajt për t'u bërë kryetar i PS-së do të ishin shumë të mëdha, sepse vetë partia brenda kërkon një rilindje dhe një njeri që t'i pastrojë nga krimi i organizuar. Ne kemi disa kandidatura shumë të mira për të qenë përballë Veliajt", theksoi Kryemadhi..

datëve për kryebashkiakë, kreu republikan, Fatmir Mediu kërkon që procesi të mos jetë i njëanshëm. Thelbi sipas tij është organizimi më i mirë i opozitës, duke mos shmangur kritikën për sjelljen e deritanishme. "Organizimin e opozitës si forcë në ide, por edhe në protestë përballë qeverisë, por duke filluar në radhë të parë në Tiranë. Është shumë e rëndësishme që opozita të lidhet me masën e vet të anëtarësisë, por edhe me masën e gjerë të qytetarëve shqiptarë", deklaroi z.Mediu. Bashkia e Tiranës është beteja më e rëndësishme zgjedhore, pasi ajo do të shihet si një test edhe për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Demokratët ende nuk kanë nisur negociatat me aleatët për mënyrën e përzgjedhjes së kandi-

datëve, apo të kushteve që do të kenë LSI, PDIU për të pasur kandidatë të tyre nën siglën e koalicionit opozitar. Beteja për Tiranën duhet se do të fokusohet më tepër te përzgjedhja e një kandidati brenda PD-së, pasi të gjithë aleatët në koalicionin janë të bindur se emri duhet të dalë brenda partisë më të madhe të koalicionit. Kjo u tha edhe nga vetë Kryemadhi, e cila theksoi: "Ne jemi duke kërkuar për një kandidat shumë të fortë përballë Veliajt, që është kandidati më i fortë i PD". Nisur nga kjo deklarata, LSI ia lë "përgjegjësinë" e zgjedhjes së kandidatit PD-së, e cila duhet të zgjedhë një emër të fortë përballë kandidatit socialist, i cili sipas të gjithave gjasave, deri tani mendohet të jetë përsëri Erion Veliajt. Nga radhët e demokratëve kanë nisur të

FATMIR MEDIU

"Organizimi i opozitës si forcë në ide, por edhe në protestë përballë qeverisë, por duke filluar në radhë të parë në Tiranë. Një opozitë, e cila në mënyrë parazitare pretendon që duhet të vendosë për çdo gjë, duke shpërfillur zërin e qytetarëve. Është shumë e rëndësishme që opozita të lidhet me masën e vet të anëtarësisë, por edhe me masën e gjerë të qytetarëve shqiptarë", tha z.Mediu.

përfliten emrat e parë për Bashkinë e Tiranës. Dashamir Shehi është një nga emrat që përflitet për të qenë kandidat i opozitës. Kreu i LZHK-së, tashmë deputet i PD-së, shihet kandidat potencial për shkak të statuturës së tij dhe mbi të gjitha si një qytetar i vjetër i Tiranës. "Unë nuk e përjashtoj. Unë gjykoj se Bashkia e Tiranës ka funksion politik, për hir të eksperiencës do t'i bëja më mirë punët. A do e shtyjme Ramën tutje? Po, për këtë arsye do e pranoja. Halim Kosova ishte burrë i mirë, por na duhet një politikë, duhet të merret me personazhe politikë. S'ka nevojë ta zgjedhim seksionin kryetarin, mjaftojnë disa sondazhe. Basha bazohet tek sondazhet që prej 10 vitesh. Nuk përjashtoj asnjë mundësi që i jep shans këtij vendi të shtyjë jashtë regjimin e Edi Ramës. Pse është më i fortë Veliajt? Unë them se ky është personazh negativ, më negativ. Sa ka ai jetë, unë kam punë. Ai është nxënës, s'ka çfarë më mëson", u shpreh Shehi.



DASHAMIR SHEHI

"Do ta gjykojmë kur t'i vijë koha. Unë nuk e përjashtoj. Bashkia e Tiranës ka funksion politik, për hir të eksperiencës, do t'i bëja më mirë punët. A do e shtyjme Ramën tutje? Po, për këtë arsye do e pranoja. Halim Kosova ishte burrë i mirë, kandidatura duhet të jetë politike. PD ka vënë personazhe të pavlera, ndaj ka humbur. Janë zgjedhje politike", tha kreu i LZHK-së.

SHKURT

Zgjedhjet në PD, kryetarët e rinj në Elbasan, Berat, Kukës dhe Kuçovë

Degët e Partisë Demokratike në Elbasan, Kukës dhe Kuçovë kanë tashmë kryetarët e tyre të rinj. Në Elbasan, Eguen Isai u zgjodh kryetar i ri i Partisë Demokratike me 378 vota. Përballë tij garonte Zamir Muzhaqi, i cili fitoi vetëm 80 vota. Në Kukës u rikonfirmua si kryetar Arif Rexhmati. Ai arriti mori 118 vota, duke mposhtur kështu sekretarin organizativ të degës, Fasli Germizini, i cili mori 16 vota. Në Kuçovë, Vehbi Luzi dhe Ilir Koxhai. Në përfundim të votimit fitoi Vehbi Luzi me diferencë prej 8 votash për kryetar partie të PD, ku votuan 180 persona. PD ka zgjedhur për një mandat të dytë Gazmend Azizin, i cili fitoi garën brenda kampit ndaj Shkëlqim Hysit. Azizi mori 172 vota, kurse rivali i tij Shkëlqim Hysi, vetëm 108 vota. Partia Demokratike vijon procesin e zgjedhjeve brenda saj, duke shtruar trasenë për zgjedhjet lokale të vitit 2019, të cilat janë dekretuar nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta më datë 30 qershor. Partia më e madhe opozitare ka përfunduar këtë proces edhe në disa qytete të tjera të Shqipërisë, veprim të cilin po e përdor si model për të transformuar në kohë Partinë Demokratike për testin e zgjedhjeve lokale.



Banorët e "Astirit" bllokojnë rrugën, kreu i PD: Ka vepër penale, Marku poshtë 'tavolinës'

Unaza, Basha: Zgjidhja, ndalimi i projektit dhe hetimi i plotë

"Në burg kush është përfshirë në skemën korruptive"

Valentina Madani

Banorët e zonës së "Astirit" në Tiranë dolën sërisht dje në protestë për banesat që do të shemben nga projekti i Unazës së Re, duke bllokuar rrugën. Protestës së banorëve pasditen e djeshme iu bashkua edhe kreu i opozitës, Lulzim Basha, si mbështetje të opozitës në mbrojtje të banesave të tyre. Sipas tij, zgjidhja e situatës është ndalimi i zbatimit të projektit dhe hetimi i plotë. Z.Basha e quajti megaafërë projektin për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës dhe tha se prokuroria e drejtuar nga Arta Marku nuk ka vepruar; megjithëse janë kryer vepra penale. Basha akuzoi kryeministrin Rama se nuk ka ndërmend të bëjë projekte apo rrugë, por ka si qëllim të vjedhë qytetarët. Kreu i opozitës dënoi ashpër edhe dhunën e ushtruar nga policia ndaj kameramanëve dhe qytetarëve. "Është shkelur ligji për pronën publike, është shkelur Kushtetuta dhe po dhunohen çdo ditë qytetarët që Edi Rama të grabisë një shumë astronomike, pa treguar asgjë për projektin. Pse po investohet në këtë pjesë të Unazës? Pse një nga kompanitë është regjistruar në parajsë fiskale, kush fshihet pas kësaj kompanie? Këto janë pyetjet që kam sot unë dhe ju ftoj ju si media të hetoni. Dua të dënoj dhunën mbi kameramanët dhe mbi gazetarët, si dhe shoqërimin e 5 protestuesve ditën e djeshme. Kjo që po ndodh këtu ka të bëjë jo thjesht me fatin e këtyre familjeve, këtu po bëhet autopsia e regjimit të Rilindjes. Këtu po tregohet se si ka rënë Kushtetuta. Prokurorja e Përgjithshme është fshetur dhe nuk reagon për denoncimin e bërë nga qytetarët. Kjo është pasqyra e vërtetë se ku ka përfunduar Shqipëria me një të çmendur, që kërkon të plaçkët shqiptarët. Ne jemi në krah të tyre, për t'u dhënë forcë, për t'u dhënë kurajë", deklaroi Basha. Kreu i PD-së denoncoi se me urdhër politik janë shoqëruar pesë qytetarë nga forcat e policisë. Sipas tij, është shkelur ligji për pronat dhe nuk ka pasur garë për projektin. "Agai i Surrelit, Edi Rama, po harxhon këtu aq lekë sa nuk investohen për arsimin në Shqipëri", - theksoi kreu i PD-së. Z. Basha hodhi akuzë edhe ndaj kryeprokurores Arta Marku, sipas të cilit ajo duhet



Kreu i PD dje mes protestuesve të zonës së 'Astirit'

AKUZA

Z.Basha tha se me urdhër politik janë shoqëruar pesë qytetarë nga forcat e policisë. Ai akuzoi se është shkelur ligji për pronat dhe nuk ka pasur garë për projektin. "Agai i Surrelit, Edi Rama, po harxhon këtu aq lekë sa nuk investohen për arsimin në Shqipëri", - theksoi kreu i PD-së.



Punimet tek Unaza e Re devijojnë qarkullimin, ja rrugët alternative

Në një kohë kur banorët e "Astirit" prej 29 ditësh janë në protestë kundër shembjes së banesave të tyre, kantieri i ndërtimit për rikonstruksionin e segmentit të Unazës së Re, nga Shkolla Teknologjike tek sheshi "Shqiponja" vazhdon prej disa ditësh. Bashkia është në përfundim të shkullës së pemëve dhe heqjes së shtyllave të ndriçimit e më pas këto hapësira do të shfrytëzohen nga firmat ndërtuese. Në fazën e parë kantieri do të ngrihet në pjesën ndarëse të rrugës dhe ngushtimi i korsive është në përfundim për gjatë gjithë gjatësisë. Bashkia e Tiranës ka deklaruar se trafiku do të menaxhohet në mënyrë që fluksi të reduktohet në pjesën e Unazës gjatë kohës që kryhen punimet. "Kemi bërë një plan menaxhimi që do t'i japë prioritet rrugës 'Dritan Hoxha' dhe Rrugës së Kavajës, ndërsa jemi duke punuar shumë fort me rrugët alternative, siç është rruga 'Tre Dëshmorët', që i shërben zonës së Kasharit dhe me mbylljen e rrugës 'Teodor Keko', do jetë një rrugë e rëndësishme përsa i takon vullmit të trafikut. Ne besojmë që nuk do të ketë bllokim trafiku, por do të ketë mbingarkesë dhe qytetarët duhet të kenë mirëkuptim, pasi është një nga aksent kryesore të qytetit të Tiranës, që i shërben të gjithë qytetit, jo vetëm zonës aty", deklaroi drejtori i Transportit në Bashkinë e Tiranës, Enton Punavia për "Top Channel". Vullmi më i madh i punimeve do të bëhet në sheshin "Shqiponja", me ndërtimin e mbikalimit. Gërmimet kanë nisur, ndërkohë në fazën e parë të punimeve, trafiku në këtë nyje do të ketë devijim të pjesshëm, duke i detyruar mjetet që vijnë nga La-praka dhe që duan të futen në Unazën e Re, që kthesën ta bëjnë tek mbikalimi i Kamzës.

Kreu i PR: Opozita e ka vendin në parlament

Mediu: Qeveria duhet t'i shpronësojë banorët e Unazës së Re

Kreu i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, i kërkoi dhe qeverisë "Rama" që të shpronësojë familjet që po u shemben shtëpitë në zonën e "Astirit". Para Asamblesë Kombëtare të PR-së, Mediu njoftoi se e ka raportuar protestën e banorëve të "Astirit" gjatë takimit të nivelit të lartë në Parlamentin Europian, në Bruksel. Ai kërkoi që qeveria t'i shpronësojë banorët e Unazës së Re, banesat dhe bizneset e të cilëve preken nga ndërtimi i projektit të Unazës së Madhe. "Në këtë takim foli edhe për protestën e banorëve të Unazës, cenimin e jetës dhe pronës. Pse protesta e tyre është e drejtë? Sepse Rama ka premtuar legalizimin e banesave bizneseve në çdo zonë informale. Një qeveri që përbuz qytetarët e vet, meriton përbuzjen e të



gjithë qytetarëve. Këto legalizime janë kryer në prona publike, ndaj është e pamoralshme. Së katërti, shteti ka marrë përsipër legalizimin e mirëfillt për përfitime politike. Përfundimisht, në mendimin tim qeveria duhet t'i shpronësojë këta banorë në vlerat e tregut", u shpreh kreu i PR-së. Mediu bëri të ditur se një tjetër çështje problematike e raportuar nga ai në Parlamentin Europian është ajo e mungesës së Gjykatës Kushtetuese. Kreu

i PR-së quajti të paprecedencë kolapsin në sistemin gjyqësor. Por me ngushtimin e afatit kohor për dëgjimin e mandateve, republikanët ishin të parët të cilët i kërkuan Lulzim Bashës të thyjë bojkotin. Nga asambleja e partisë, Fatmir Mediu i kërkoi liderit demokrat të reflektonte për qëndrimet që opozita duhet të mbajë me parlamentin. "Parlamenti nuk është parlamenti i Edi Ramës. Parlamenti për opozitën duhet të jetë zëri i së vërtetës, zëri i qytetarëve. Ai është i vetmi institucion ku edhe nga pikëpamja formale, opozita është pjesë", tha z.Mediu. Republikanët këmbëngulën në ndryshimin e sistemit zgjedhor, duke mbështetur idenë e një sistemi proporcional, me lista të hapura.

të kishte nisur hetimin për atë çfarë po ndodh në Unazën e Madhe. "Unë do ta anuloj këtë tender korruptiv, do të hetoja dhe do të çoja para drejtësisë dhe në burg të gjithë ata që janë përfshirë në këtë skemë të madhe korruptive. Këtu po tregohet sesi po shkelet Kushtetuta dhe sesi shteti ka rënë. Prokurorja Arta Marku është

fshur; është futur poshtë tavolinës dhe ka frikë të nxjerrë fytyrën për kallëzimin që kanë bërë qytetarët", deklaroi z.Basha. Banorët kërkojnë shpronësim dhe dëmshpërblim, ndërkohë që Bashkia Tiranë u ka ofruar atyre një bonus qiraje për 3 vite. Para dy ditësh policia shoqëroi 5 protestues, të cilët dyshohet se

ishin protagonistë në aktet vandale të protestës së pak ditëve më parë, ku u dogjën goma dhe u bllokua rruga për disa orë. Protesta e banorëve të "Astirit" vijon paralelisht me ndërrhyrjen që IKMT-së po zhvillon duke shembur objektet e ndërtruara pa leje në këtë zonë për t'i hapur rrugë ndërtimit të Unazës.

AMNISTIA VOTIMI

Manjani: Rama po bën lojë të pisët me amnistinë, kërkon të joshë opozitën

Amnistia rrezikon të dështojë, mazhoranca nuk i ka 84 vota

Ligjet për amnistinë miratohen me tre të pestat

Qeveria ka përgatitur ligjin për amnistinë e fundit të vitit 2018 dhe ia ka nisur për dhënie mendimi Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme për të dalë në një version përfundimtar dhe të pranueshëm për personat që do të përfitojnë. Por ky projektligj rrezikon të mbetet thjesht në letër. Kjo, pasi mazhoranca në parlament nuk i ka votat për ta miratuar. Sipas Kushtetutës, në nenin 81 të saj në pikën 'e', thuhet se ligjet për amnistinë miratohen me tre të pestat e anëtarëve të gjithë anëtarëve të Kuvendit, pra 84 vota, që Partia Socialiste me aleatët nuk i ka. Sipas "Ora News" për të votuar ligjin e amnistisë, do të duhet që socialistët të arrijnë konsensusin me opozitën ose t'i rrëmbëjnë asaj 5 deputetë. Konsensusi me opozitën nuk duket i lehtë, sepse prej 4 muajsh tashmë, deputetët e Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integritet kanë bojkotuar parlamentin dhe kanë vënë si kusht vetëtimin e politikave për rikthimin e tyre. Në këto kushte, shpresa mbetet tek Komisioni i Venecias, i cili më datën 14 dhjetor miratonte opinionin për projektligjin e propozuar nga Partia Demokratike për vetëtimin në politikë. Kjo do të thotë se palët politike do të kenë një dokument mbi të cilin do të punojnë dhe kjo mund të jetë një arsye për kthimin e opozitës në Kuvend. Një tjetër ligj i rëndësishëm, i cili do të duhet të kalojë është ligji zgjedhor për të cilin palët kanë bërë përparime dhe vijojnë negociatat për të përmbyllur dhe pikat e fundit. Ky ligj mund të kalojë në parlament në fund të dhjetorit dhe sërisht kërkohet 84 vota. Mbi 600 persona që vuanë dënimin e tyre mund të mos e gëzojnë lirinë ose uljen e dënimit për shkak të mosmarrëveshjeve politike me qeverinë dhe opozitën. Amnistia e fundit është kryer në fundin e vitit 2016, ku PS dhe LSI së bashku me PBDNJ ishin bashkë në një koalicion dhe kishin 88 vota. Atë kohë votat e opozitës nuk ishin të nevojshme, edhe pse PD ishte kundër amnistisë së atij viti.

AKUZA
Ish-ministri i Drejtësisë,



Vendet bosh të opozitës në Kuvend

VOTIMI

Projektligji për amnistinë rrezikon të mbetet në letër. Kjo, pasi mazhoranca në parlament nuk i ka votat për ta miratuar. Sipas Kushtetutës, në nenin 81 të saj, në pikën 'e', thuhet se ligjet për amnistinë miratohen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, pra 84 vota, që PS me aleatët nuk i ka.

Indeksi i skllavërisë moderne në Shqipëri

Trafikimi i qenieve njerëzore, Çupi: Duhet të ndërjegjësohemi

Deputetja e PD-së, njëherësh kryetarja e Aleancës së Grave Parlamentare, Dhurata Çupi reagoi dje në lidhje me raportin e fundit, që e rendit Shqipërinë në vendet e fundit, ku është shumë prezentë skllavëria moderne. "Sipas Indeksit Global të Skllavërisë Moderne 2018, i Fondacionit 'Walk Free', Shqipëria renditet e 43 nga 167 ekonomi të analizuara. Ku të paktën 20 mijë shqiptarë mund të quhen skllavër të kohëve moderne, e për këtë 'merita' i ka qeveria që 'po merr masat' që të varfërojë gjithnjë e më shumë shqiptarët. E më shumë shqiptarët, Rama u dhënat e këtij indeksi u

referohen çështjeve si trafikimi i njerëzve, puna e detyrueshme, martesat e detyruara, apo shitja dhe shfrytëzimi i fëmijëve", shprehet zj.Çupi. Sipas saj, në këtë mënyrë e rilindi Shqipërinë Edi Rama, duke u sjellë si pasha në tokën e tij, ndërsa po detyron të shkojë nga sytë këmbët popullin e tij. "Nuk e di nëse kryeministri i ka lexuar të dhëna të tilla alarmante, por di që edhe po t'i lexonte, nuk i bën përshtypje. Kjo, sepse ai skllavërimin ndaj të pamundurave e ka mënyrë qeverisjeje. Duke i blerë shqiptarët në çdo palë zgjedhjeje, Rama u merr dinjitetin dhe u të vetëm

frymën për të jetuar. Shqiptarët duan punë, dinjitet e mirëqenie. Shqiptarët nuk duan lëmsh dhe nëpërkëmbje. Me politikën e ndjekura në këto 5 vite, qeveria jo vetëm që është treguar e pamëshirshme ndaj të pamundurave, duke u hequr çmimet e larta të ujit e dritave. Duhet të ndërjegjësohemi të gjithë së bashku çdo ditë, jo vetëm sot si Dita Ndërkombëtare e Luftës Kundër Skllavërimit Modern".

Ylli Manjani e cilësoi një lojë të pisët politike vendimin për amnistinë për të dënuarit. Përmes një postimi në "Facebook", Manjani thekson se qeveria ka përgatitur amnistinë, por nuk i ka 84 vota në Kuvend për ta kaluar. Sipas Manjanit, qeveria kërkon të joshë opozitën që kjo e fundit të braktisë bojkotin parlamentar. "Loja e pisët me amnistinë.

Qeveria ka përgatitur një amnisti për disa të dënuar; por nuk i ka 84 vota në Kuvend për ta kaluar. Në këto kushte, amnistia e propozuar nuk motivohet nga humanizmi, por thjesht nga loja politike. Qeveria kërkon të joshë opozitën të braktisë bojkotin parlamentar. Të fshijë nga axhenda politike e saj kërkesat për dekriminalizim të poli-

tikës, garantimin e zgjedhjeve të ndershme dhe drejtësinë e çliruar nga qeveria. Në rastin më të mirë për qeverinë, një përçarje e mundshme e opozitës do ishte rezultati më i preferuar. Pra, një pjesë e deputetëve të paraqiten për të votuar amnistinë, në emër të humanizmit, është qëllimi i preferuar i qeverisë.", shprehet ish-ministri i Drejtësisë.



"Lajmet e rreme", Edi Rama sfidon portalet: Gjohë për shpifësit

Në një konferencë mbledhëse të djeshme, kryeministri Edi Rama paralajmëroi se të gjitha ato media, portale, të cilat bëjnë lajme të rreme, "fake", do të ndëshkohen rreptësisht dhe po i njëjti ndëshkim do të jetë edhe për të gjitha ato portale që e marrin nga media e origjinës. Kryeministri Rama deklaroi se lajmet e rreme po shpërndahen me shpejtësi falë kontributit edhe të ndjekësve. Kjo sipas shefit të qeverisë do të luftohet përmes përmirësimit të legjislacionit, duke përdorur edhe mjetet e dënimit të shpifësve përmes gjohës. "Lajmet e rreme dhe shpifjet kishin një ndjekje më të madhe dhe ishin disafish më të përhapura me kontributin e ndjekësve se sa lajmet e vërteta. Natyra e tërheqjes së shpifësve, sponsorizimi i lajmeve nga faktorë nga më të ndryshmet. Edhe ne e kemi përjetuar pjesën e kësaj historie të hidhur. Shqipëria e dalë nga vite të tëra izolimi, ka qenë një vend goxha pjellor për sa u takon shpifjeve dhe lajmeve të rreme", tha Rama.



PËRMIRËSIMI I LEGJISLACIONIT
Gjithashtu, Rama theksoi faktin se krahas masave për të parandaluar shpifjet, autoritetet përkatëse do hartojnë politika për të përmirësuar legjislacionin e platformave "online". Sipas tij, këto platforma nuk dihet se nga kush financohen dhe për çfarë qëllimi marrin para. Rama paralajmëroi gjithashtu masa për të garantuar të drejtën e autoritit në media. "Në gjashtë vitet e fundit janë hapur më shumë se 600 me parashtesën 'al'. Nuk dihet se kush i financohen dhe cilat janë edhe qëllimet e hapjes së tyre. Ne do të vendosim rregulla, që duke bërë disa ndërhyrje nuk do të jetë me prekje të Kodit Penal apo Civil, por një përditësim të legjislacionit ekzistues. Do të rrisim gjohat për lajmet e rreme. Të garantojmë të drejtat e autorit. Do ndëshkojmë përhapësin e shpifjeve, cili do që e merr dhe e replikon është po aq përgjegjës sa media e fillimit", shtoi kryeministri Rama.



Eurodeputeti: Pikat ku ne do të donim të shihnim më shumë rezultate

Fleckenstein, BE-së: Hapni negociatat, ose humbisni besueshmërinë

"Nëse shtyhen sërish, pasoja negative për rajonin"

Valentina Madani

Knut Fleckenstein, raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian i bën thirrje Bashkimit Evropian që të hapë negociatat me Shqipërinë qershorin e vitit të ardhshëm, në të kundërt sipas tij, Evropa do të humbasë besueshmërinë. Madje, Knut Fleckenstein paralajmëron se nëse Shqipërisë i shtyhen sërish negociatat për anëtarësim në qershor të 2019-ës, atëherë do të kishte jo vetëm pasojë negative për rajonin, por vetë institucionet europiane do të humbin besueshmërinë. Fleckenstein shprehet për TV "Klan" se me raportin që hartoi për ecurinë e reformave në Shqipëri e që mori miratimin e Parlamentit Evropian javën e shkuar, kërkohej t'i përcillej një mesazh Këshillit të Ministrave të BE. "Mesazhi kyç për Shqipërinë është: Vazhdoni kështu, por ka gjithashtu disa pika, ku ne do të donim të shihnim më shumë rezultate. Por ishte një mesazh drejtuar gjithashtu Këshillit të Ministrave, që ne i mbahemi vendimit tonë dhe negociatave dhe kërkojmë që ato të hapen vitin e ardhshëm. Nëse kjo nuk ndodh, nuk do ketë rrjedhoja negative vetëm për rajonin, por edhe për institucionet europiane. Nëse ato nuk janë të besueshme, atëherë harroji ato", deklaroi z. Fleckenstein.



Knut Fleckenstein, raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian

VETINGU
"Nuk kam dyshim se procesi i vetingut do të vazhdojë dhe se postet vakante do të mbushen. E kuptoj që është një situatë e vështirë, por kjo mund të ndodhë në një fazë të tillë tranzitore. Problemet nuk mund të zgjidhen të gjitha njëkohësisht. Duhet pak durim për këtë. Nga ana tjetër është absolutisht e nevojshme që gjykatat dhe prokuroritë të funksionojnë dhe që këto poste vakante të mbushen", tha Fleckenstein.

MESAZHI

"Ishte një mesazh drejtuar gjithashtu Këshillit të Ministrave, që ne i mbahemi vendimit tonë, mbështesim KE-në për hapjen e negociatave dhe kërkojmë që ato të hapen vitin e ardhshëm. Nëse kjo nuk ndodh, nuk do ketë rrjedhoja negative vetëm për rajonin, por edhe për institucionet europiane. Nëse ato nuk janë të besueshme, atëherë harroji ato", deklaroi z. Fleckenstein.

SHKURT

Meta: Ti jepet fund plagës së skllavërisë moderne

Presidenti Ilir Meta bën apel të fortë për të mbështetur viktimat e skllavërisë moderne dhe jo të trajtohen si shifra nëpër raporte. Në Ditën Botërore për Zhdukjen e Skllavërisë, kreu i shtetit shqiptar shprehet se kjo është një plagë që shkatërron familjen e shoqërinë dhe ndihmon krimin e organizuar. Sipas Metës, këta njerëz nuk duhet që të trajtohet vetëm si shifra nëpër raporte dhe t'u jepet fund plagëve të kësaj skllavërie që shkatërron jetë. "Në Ditën Botërore për Zhdukjen e Skllavërisë apeloj fort për të menduar për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të skllavërisë moderne, të cilët janë njerëz dhe nuk meritojnë të trajtohen si shifra nëpër raporte. Fund plagës së skllavërisë moderne që shkatërron jetë, familje e shoqërinë dhe ushqen krimin e organizuar në kurriz të stabilitetit, sigurisë e sundimit të ligjit", shkruan presidenti në "Facebook".

"Kaçifas", Omonia: Kërkojmë hetime për ngjarjen

OMONIA e Korçës iu rikthye sërish dje vrasjes së Kostan din Kaçifas në Bularat të Gjirokastrës. Kreu i OMONIAS, Ligorag Karamelo tha se vrasja e Kaçifas është ngjarje tragjike dhe e shëmtuar. Kërkojmë nga shteti shqiptar të zbardhet e vërteta. Sipas Karamelos, policia tejkaloi kompetencat dhe shkeli të drejtën e jetës së një qytetari të minoritetit grek, ndaj duhet transparentë për ecurinë e hetimeve të vrasjes së Kaçifas dhe shkaqet pse ndodhi ngjarja. Karamelo gjithashtu tha se, "kërkojmë sqarime nga Ministria e Brendshme dhe e Jashtme, për vendimin ekstrem të shpalljes non grata të eurodeputetes qipriotë, Theoharos dhe 52 personave të tjerë".

"Ish-sigurimisat udhëheqin në majat e shtetit"

Bylykbashi: Turp, Rama po rikthen në drejtësi ish-xhelatët e komunizmit

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi, shpreh shqetësimin se kryeministri Edi Rama po rikthen në sistemin e drejtësisë ish-xhelatët e diktaturës, të cilët firmosën pushtatimin dhe persekutimin e mijëra shqiptarëve të pafajshëm. Përmes një statusi në "Facebook", Bylykbashi kujton se: "Shqiptarët njohën formën më kriminale të komunizmit për gjysmë shekulli nën thundrën e Enver Hoxhës. Mijëra të vrarët e të zhdukurit me gjyq e pa gjyq në Shqipëri, foshnjat e vdekur nga uria, dizantëria dhe vuajtjet në kampin e Tepelenës, dhjetëra mijëra të burgosurit dhe të

internuarit politikë, qindra mijëra jetë e familjarëve të shkatërruara përgjatë një gjysmë shekulli nga kriminelët e komunizmit shqiptar, janë jo thjesht ish-të përndjekur. Nuk janë listë emrash për dëmshtëpërlim. Janë monument i gjallë ulëritës i kujtesës së krimeve kundër njerëzimit që kanë kryer hierarkët e byrosë politike, xhahilët në Sigurim, gjykata, prokurori dhe hetuesi që sot po na kthehen në drejtësi përmes reformës së Edi Ramës, bashkëpunëtorët që dëshmuar për t'i dënuar të pafajshmit, komandantët dhe gardianët e burgjeve dhe kampeve të përqendrimit dhe që ende

nuk kanë njohur ndëshkimin e drejtësisë për krimet e tyre kundër njerëzimit", shprehet deputeti i PD-së. Ai përmend me tej: "Mbi 30 anëtare byroje politike dhe zyrtarë të lartë të komunizmit u dënauar për krime kundër njerëzimit midis 1992 dhe 1997, por pasuesit e komunistëve i falën dhe u dhanë para si dëmshtëpërlim, sepse ata kriminelë na ishin dënauar 'pa të drejtë'. Sot disa prej tyre, apo ata pasues krenarë të tyre, udhëheqin në majat e shtetit. Turp! Sa kohë nuk ka drejtësi për këto krime, nuk do të ketë paqe sociale".

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të reja kushtetuese, sidosomos Reformës në Drejtësi mori jetë një nga organet më të rëndësishme të kësaj reforme, e cila do të kalonte në sitë emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë ushtruar profesionin përgjatë viteve të pluralizmit në vendin tonë. Më 19 janar të 2018-ës, nën asistencën e ekspertëve amerikanë dhe Bashkimit Evropian nisi procesi i vetingut, vendimtar për të pastruar

sisht. Duhet pak durim për këtë. Nga ana tjetër është absolutisht e nevojshme, që gjykatat dhe prokuroritë të funksionojnë dhe që këto poste vakante të mbushen", theksoi z. Fleckenstein. Në raportin e miratuar nga Parlamenti Evropian i kërkohej klasës politike në Shqipëri të miratonin reformën zgjedhore si dhe të bashkëpunimin në parlament për reformat që kërkohen nga vendi ynë për t'u çelur negociatat.

sistemin e drejtësisë nga gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar. Kështu, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nisi kontrollin e 794 prokurorëve dhe gjyqtarëve për të tria kriteret, pasurinë, figurën dhe integritetin profesional. Prioritet nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u është dhënë subjekteve rivlerësuese, që janë edhe kandidatë për organet e reja të drejtësisë, KLPG-së, KLP-së dhe KED-së.

MASA E PENSIONEVE RISHQYRTIMI NGA ISSH

Voltiza Duro

"e-Albania": Mund të merrni pagesë më të lartë dhe zgjatje të afatit të përfuturimit

Ja si të rrisni masën e pensionit, procedura e rishqyrtimit dhe aplikimi

ISSH: Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët

Pas mbushjes së moshës së përcaktuar, të moshuarve iu lind e drejta për të përfutur pension pleqërie. Por, pas caktimit të masës së pensionit, jo pak përfutues shfaqin pakënaqësi në lidhje me pagesën do të marrin për vitet që kanë punuar me kontribute. Për të gjithë të interesuarit, "Gazeta Shqiptare" publikon sot procedurën që duhet të ndjekin pensionistët për të rritur masën e pensionit. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se paraprakisht duke bërë një kërkesë në portalin qeveritar "e-Albania" si dhe dokumentacionin e plotë që duhet të dorëzojnë të interesuarit.

APLIKIMI DHE KËRKESA

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfutuesi ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfuturimi, ose për zgjatjen e afatit të përfuturimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm. Ky shërbim ju ofron mundësinë për të plotësuar një kërkesë "online" për rishqyrtimin e përfuturimit tuaj (sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar), - theksohet në portalin qeveritar "e-Albania". Për të pasur akses në këtë të fundit, të interesuarit duhet të regjistrohen si qytetarë në portal dhe të plotësojnë formën përkatese për këtë kërkesë, e cila do të hapet menjëherë pas klikimit të butonit "Përdor" në krah të këtij shërbimi. Më tej në portal bëhet me dije se numri i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që aplikanti hyn në portal me kredencialet e tij përkatese.



"Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave. Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë. Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore", - nënvizon "e-Albania" për të gjithë pensionistët që dëshirojnë të aplikojnë për rishqyrtim të masës së pensionit. Ndërko-

hë, të gjithë aplikantët pasi të kenë përdorur këtë shërbim elektronik, duhet të paraqiten në zyrat e agjencive lokale për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. **DOKUMENTACIONI** Dokumentet e nevojshme për rishqyrtim janë në varësi të objektit të rishqyrtimit. Por, aplikantët duhet të kenë parasysh që të dorëzojnë një kopje të kartës së identitetit ose certifikatë personale, një certifikatë familjare, vërtetim për pagat pas vitit 1993, vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë, vërtetim për kontributet si i

vetëpunësuar në bujqësi, vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak, vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç-25 vjeç, vërtetim nga Tatim-Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim, si dhe një vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar. Ndërkohë, të interesuarit duhet të dorëzojnë edhe një fotokopje të kontratës me KESH-in, dëshminë e penaltetit për të përndjekurit politikë, vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë), diplomën e shkollës së lartë, fletëdrejtimi për në KMCAP dhe fletëdaljet nga spitali, analiza mjekësore sipas diagnozës, vërtetim identiteti, aktverifikim, vendim gjykatë, deklaratë individuale për punësim (e përvitshme) mod. 09, si dhe një deklaratë individuale që nuk është i punësuar (mod. 08). Gjithashtu, pensionistët duhet të paraqesin pranë zyrave përkatese edhe vërtetimin e pagës referuese modelar nr.02, vërtetim i pagës mesatare referuese modelar nr.03, vërtetim i viteve të shërbimit mod. nr.03, vërtetim për derdhje të kontributit suplementar nr.08, vërtetim page referuese të përfuturimit shtetëror suplementar, vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë, vërtetim për derdhje të kontributit suplementar, vërtetim i pagës referuese, si dhe një vërtetim për periudhën e shërbimit.

APLIKIMI

Pas marrjes së vendimit të caktimit të pensionit, përfutuesi ka të drejtë të aplikojë për rishqyrtim pensioni për të dorëzuar dokumentacion shtesë, për një masë më të lartë përfuturimi ose për zgjatjen e afatit të përfuturimit për pensionet invalid, familjar dhe suplementar të parakohshëm.



DOKUMENTET QË MUND TË DORËZOHEN JANË:

- Kopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale.
- Certifikatë familjare.
- Vërtetim për pagat pas vitit 1993.
- Vërtetim nga arshiva e ISSH-së, DRSSH-së për vjetërsi në punë.
- Vërtetim për kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi.
- Vërtetim për kohën e kryerjes së shërbimit ushtarak.
- Vërtetim nga shkolla, kur fëmija është 18 vjeç-25 vjeç.
- Vërtetim nga Tatim-Taksat për pjesëtarët që ka në ngarkim.
- Vërtetim nga Zyra e Punës si punëkërkuar.
- Fotokopje të kontratës me KESH-in.
- Dëshmi penaltetit për të përndjekurit politikë.
- Vërtetim i kohës së vuajtjes së dënimit (të përndjekurit politikë).
- Diplomën e shkollës së lartë.
- Fletëdrejtimi për në KMCAP dhe fletëdaljet nga spitali.
- Analiza mjekësore sipas diagnozës.
- Vërtetim identiteti.
- Aktverifikim.
- Vendim gjykatë.
- Deklaratë individuale për punësim (e përvitshme) mod. 09.
- Deklaratë individuale që nuk jam i punësuar (mod. 08).
- Vërtetim i pagës referuese modelar nr.02.
- Vërtetim i pagës mesatare referuese modelar nr.03.
- Vërtetim i viteve të shërbimit mod. nr.03.
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar nr.08.
- Vërtetim page referuese të përfuturimit shtetëror suplementar.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit në funksion apo detyrë.
- Vërtetim për derdhje të kontributit suplementar.
- Vërtetim i pagës referuese.
- Vërtetim për periudhën e shërbimit.

HAPAT E PROCEDURËS

- Për të përdorur shërbimin, duhet të regjistroheni si qytetar në portal dhe të plotësoni formën përkatese për këtë kërkesë, e cila hapet menjëherë kur klikoni butonin "Përdor" në krah të këtij shërbimi.
- Numri juaj i sigurimit plotësohet paraprakisht në momentin që ju hyni në portal me kredencialet tuaja.
- Me informacionin e numrit tuaj të sigurimit plotësohen automatikisht edhe të dhënat e tjera nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- Ju duhet të plotësoni formularin sipas fushave.
- Numri dhe data e protokollit do plotësohet nga punonjësit tanë.
- Ju mund ta ruani formën si draft për të vazhduar në një moment tjetër, ose mund ta dërgoni menjëherë për procesim në serverin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.



"Kufijtë e pagesës që mund të kryeni dhe tarifatat mujore. Si të merrni më shumë të ardhura"

ISSH: Si të përfitoni pension pleqërie nëpërmjet sigurimit vullnetar

"Ja zbritjet që mund të kenë nga parapagimet"

Voltiza Duro

Të gjithë ata që nuk i kanë plotësuar vitet e punës me kontribute për të përfituar pension, tashmë kanë një zgjidhje. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën thirrje jo vetëm për të moshuarit që nuk i kanë plotësuar vitet e punës, por edhe për ata që dëshirojnë të marrin një pension të plotë që të bëjnë sigurim vullnetar. Ndërkohë, ISSH bën me dije për të gjithë të interesuarit se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar, ndërsa pensioni i pjesshëm kërkon minimalisht 15 vite pune me siguri.



esat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar); - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar)", - theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Gjithsesi, pagesat e vitit korrent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale.

SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguajnë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të sigurar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korrent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 lekë dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë, punëmarësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënësi që sigurohet nën nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page, ndërsa çdo kontribuues vullnetar për vitin korrent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

e të vetëpunësuarve në bujqësi, ose në rastet kur individit i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare. "Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfitues, sipas rastiit, i pensionit të plotë të pleqërisë, pensionit të pjesshëm të pleqërisë, pensionit të reduktuar të pleqërisë, pensionit të invaliditetit, pensionit të pjesshëm të invaliditetit", - thekson ISSH. Ndërkohë, në sigurimin vullnetar, sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributit vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i sigurar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Njëpërmjet sigurimit vullnetar mbulohet edhe katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korrent, sigurim vullnetar për periudha të kaluara, sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur

moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar, si dhe personat që kanë lënë shtetësinë. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritjet.

SIGURIM VULLNETAR PËR VITIN KORRENT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar për vitin korrent nga personi i interesuar është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. "Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pag-

6%

ZBRITJE PARAPAGESË 1 VIT

"Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave, do të ketë zbritje 6% mbi shumën për një pagesë vjetore", - bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore në faqen e tij zyrtare.

3%

ZBRITJE PARAPAGESË 6 MUAJ

ISSH bën me dije se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave, do të ketë zbritje 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore.

PERIUDHAT E KALUARA

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- Kanë mbushur moshën 18 vjeç.
- Që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.
- Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasuniversitare është me pagesë.
- Ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë.
- Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa.
- Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritjet.

► të kaluarën dhe të tashmen, t'ju sigurojmë të ardhmen!", - bën thirrje Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Njëpërmjet sigurimit vullnetar, mund të përfitojnë jo vetëm emigrantët shqiptarë, por të gjithë qytetarët që jetojnë në Shqipëri e dëshirojnë të kenë një masë pensioni më të lartë se ai që është paracaktuar më parë.

KUSHTET

Në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar, ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm si dhe personat që janë të sigurar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën

Në sitë 1136 subjekte, dyqane, supermarkete dhe tregje të shumicës

Policia, kontroll në tregje për kapsolla e lëndë plasëse

Masat, pas plagosjes së polices në protestë

Policia nis kontrollin në tregje për lëndë plasëse, përfshi edhe kapsollat. Situata erdhi nga ngjarja e fundit, ku gjatë një proteste para parlamentit mbeti e plagosur nga një kapsollë efektive Ina Nuka, e cila humbi dy gishtat e dorës. Policia e Shtetit ka ndërmarrë një plan masash për parandalimin dhe sekuestrimin e kapsollave dhe lëndëve piroteknike me rrezikshmëri për jetën e qytetarëve. Që prej disa ditësh vijon zbatimin e detyrave të përcaktuara në planin e masave për kontrollin e tregjeve dhe bizneseve që kryejnë aktivitet në tregtimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve. "Në këtë kuadër, bazuar edhe në Ligjin nr.9126, datë 29.07.2003 'Për përdorimin civil të lëndëve plasëse, lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve në Republikën e Shqipërisë' si dhe Urdhrit të MB nr. 229, datë 08.05.2015 'Për miratimin e rregullores për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit dhe përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve', gjatë ditëve të fundit në të gjithë vendin nga strukturat e policisë është ushtruar kontroll në subjekte (dyqane dhe tregje), 'Për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve'. Janë kontrolluar 1136 subjekte (dyqane apo supermarkete) si dhe tregje të shumicës. Si rezultat i kontrolleve janë sekuestruar 643 kapsolla, si dhe 487 fishekzjarrë, që dy-

MASAT

Policia e Shtetit ka ndërmarrë një plan masash për parandalimin dhe sekuestrimin e kapsollave dhe lëndëve piroteknike me rrezikshmëri për jetën e qytetarëve. Që prej disa ditësh vijon zbatimin e detyrave të përcaktuara në planin e masave për kontrollin e tregjeve dhe bizneseve që kryejnë aktivitet në tregtimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve.



Foto Illustruese

KONTROLLET

Janë kontrolluar 1136 subjekte (dyqane të ndryshme, markete apo supermarkete) si dhe tregje të shumicës. Si rezultat i kontrolleve janë sekuestruar 643 kapsolla, si dhe 487 fishekzjarrë, që dyshohet se kanë në përbërje lëndë shpërthyes me rrezikshmëri për jetën. Janë dërguar materialet për vlerësim në prokurori për 3 subjekte, ku janë gjetur dhe sekuestruar kapsolla.

shohet se kanë në përbërje lëndë shpërthyes me rrezikshmëri për jetën. Janë dërguar materialet për vlerësim në prokurori për 3 subjekte, ku janë gjetur dhe sekuestruar kapsolla. Kontrollat janë përqendruar edhe në verifikimin e plotësimin të masave shtesë të sigurisë, si kamera dhe fikse zjarri. Policia e Shtetit u bën thirrje të gjitha bizneseve që të mos tregtojnë kapsolla apo lëndë piroteknike, si dhe të plotësojnë kushtet dhe kriteret

për magazinimin dhe tregtimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve, konform ligjit. Policia e Shtetit u bën thirrje prindërve që mos të lejojnë fëmijët të përdorin të tilla mjete shpërthyes, pasi janë rrezik potencial për jetën e tyre dhe të tjerëve, si dhe fton qytetarët për të denoncuar çdo rast të tregtimit të lëndëve të mësipërme në numrin pa pagesë 112 apo në aplikacionin 'Komisariatit Dixhital', thuhet në njoftimin e policisë.

USHTARËT SHQIPTARË SHPËTOJNË 84 EMIGRANTË NË EGJE

Anija e Forcës së Armatosur "Lissus" ka shpëtuar 84 persona në dy operacione të njëpasnjëshme në detin Egje. Në kuadër të parandalimit dhe shpëtimit të emigrantëve, operacioni i parë u zhvillua të shtunën në orën 21:35 dhe i dyti të dielën në orën 10:25. Sipas informacioneve që përcjellë Ministria e Mbrojtjes, në gomonen e parë kishte 39 persona në bord, 31 palestinezë dhe 8 sirianë. Ndërkohë, në gomonen e dytë kishte 45 persona në bord; 31 burra, 5 gra dhe 9 fëmijë.



FOTOLAJM

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER OPPORTUNITY FOR DUTY FREE BUSINESS AT TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA)

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

DUTY FREE
• Approx. 282 m²;

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Qualification and Experience with the object "Duty Free Management" (interested parties must provide examples / references); Information must be provided on similar current activities, number, size and location of outlets, years of operation, annual turnover in the last three years (or from the date of operation), total number of employees;
- Financial solidity, excellent standing and capability of the company; minimum relevant turnover in the last financial year of EUR 1,000,000 in the relevant field (interested parties must provide Profit & Loss statement of last three years);
- Relevant software/IT and data management experience concerning the Duty Free system used in the duty free areas managed by the company (interested parties must provide examples / references);
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal and sign the Confidentiality Commitment Document, which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas;
- Only to the companies that will submit the confidentiality commitment will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals;
- The Request for Proposal will be distributed only on 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time, which, documents will be delivered in a CD, free of charge.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address not later than 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time:

Tirana International Airport N'n' Tereza SH.P.K
Administration Building
Commercial & Property Department
Rinas, Albania

Emails:
Commercial Department
Legal Department
Procurement Department

Alisa Gjinari agjinari@tirana-airport.com
Ilir Alimema ialimema@tirana-airport.com
Albi Palushi apalushi@tirana-airport.com

Historia e të riut që kapërceu kangjellat e komisariatit

U arratis bujshëm tri vite më parë, pranga Bledar Zefit

29-vjeçari është dënuar 10 vite në Itali

Bledar Zefi është 29-vjeçari, i cili u arrestua ditën e diel për llogari të shtetit italian, pasi ishte dënuar me 10 vite burg për pjesëmarrje në një bandë kriminale. I riu u arrestua më herët edhe në 2015-ën nga forcat e policisë, por vetëm dy orë pas prangosjes, ai mundi të arratiset nga ambientet e komisariatit. Në nëntor të vitit 2015, Bledar Zefi u shpëtoi efektivëve dhe u arratis. Sot, tri vite nga largimi i Bledar Zefit, 29-vjeçari u arrestua sërish për llogari të Italisë, për veprën penale vjedhje me armë të organizuar në grup kriminal. Ai është i dënuar në shtetin fqinj me 10 vite burgim nga Gjykata e Xhenovës. Bledar Zefi do të ekstradohet në Itali për të vuajtur dënimin.

ARRATISJA E ZEFIT

Në nëntor të vitit 2015, Bledar Zefi u shpëtoi efektivëve dhe u arratis nga komisariati nr.3 i Policisë së Tiranës. Ai ishte arrestuar po atë ditë si person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Italia. Por vetëm dy orë më vonë pas arrestimit, u arratis nga ambientet e komisariatit. Bledar Zefi, në atë kohë 26 vjeç, shfrytëzoi kohën për të dalë nga dhoma e shoqërimit për nevoja personale dhe duke shfrytëzuar neglizhencën e efektivëve përgjegjës arriti të largohej. Ai goditi shoqëruesit dhe kapërceu kangjellat e komisariatit. Kujtojmë se komisariati sapo ishte inauguruar nga ministri i Brendshëm i asaj kohe, Saimir Tahiri. Lidhur me këtë ngjarje u arrestuan edhe dy punonjës policie, Arsela Hajdinaj, me detyrë trup shërbimi patrulle dhe Bajram Elezi, me detyrë ndihmësspecialist dhe përgjegjës i dhomave të sigurisë për veprën penale të "shpërdorimit të detyrës", por më pas ata u lanë të lirë.

ARRATISJA

Në nëntor të vitit 2015, Bledar Zefi u shpëtoi efektivëve dhe u arratis nga komisariati nr.3 i Policisë së Tiranës. Ai ishte arrestuar po atë ditë si person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Italia. Por vetëm dy orë më vonë pas arrestimit, u arratis nga ambientet e komisariatit. Bledar Zefi, në atë kohë 26 vjeç, shfrytëzoi kohën për të dalë nga dhoma e shoqërimit për nevoja personale dhe duke shfrytëzuar neglizhencën e efektivëve përgjegjës arriti të largohej.



I arrestuari Bledar Zefi

RRIHET SHQIPTARI

Një 28-vjeçar ka rënë pre e dhunës nga disa persona, pasi ishin zënë për rregullat e qarkullimit. Ngjarja ndodhi të shtunën mbrëma në Firence të Italisë. Mediat italiane raportojnë se i riu shqiptar është ndjekur nga 3 afrikanë në një lokal në vendin e tij të punës dhe më pas është sulmuar. "Ansa" shkruan se 28-vjeçarit i ka shkuar në ndihmë edhe shefi i tij, i cili po ashtu ka rënë pre e dhunës.

Të rinjtë: E bëmë për të shlyer borxhet që kishim kur erdhëm emigrantë

Rrisnin drogë në restorant, burg dy shqiptarëve

Dy shqiptarë janë dënuar me 3 vite burg në Angli për shkak të përfshirjes në rritjen e drogës, kryesisht të kanabisit. Ata janë dënuar pasi u kapën duke rritur mbi 1400 rrënjë kanabisi, vlera e të cilit nëse do dilte në treg përlllogaritë rreth 1 milion sterlina. Gjykata e qytetit Hull në veri të Anglisë dha vendimin për dy shqiptarët e identifikuar si Ervis Bashllari si dhe Puto Kamberi, njëri 31 vjeç dhe tjetri 21 vjeç. Sipas mediave angleze, shqiptarët kishin hyrë në këtë aktivitet për shkak të borxhit, pasi kishin paguar plot 11 mijë sterlina për të hyrë ilegalisht në tokën angleze. Fabrika e kanabisit u gjet në bodrumin e një restoranti indian, ndërsa prokurori i çështjes e konsideroi operacionin kriminal dhe të sofistikuar. Gjatë



VENDIMI

Gjykata e qytetit Hull në veri të Anglisë dha vendimin për dy shqiptarët e identifikuar si Ervis Bashllari si dhe Puto Kamberi, njëri 31 vjeç dhe tjetri 21 vjeç. Sipas mediave angleze, shqiptarët kishin hyrë në këtë aktivitet për shkak të borxhit, pasi kishin paguar plot 11 mijë sterlina për të hyrë ilegalisht në tokën angleze. Fabrika e kanabisit u gjet në bodrumin e një restoranti indian, ndërsa prokurori i çështjes e konsideroi operacionin kriminal dhe të sofistikuar.

kontrollit në vendin ku u gjet sasia e kanabisit, një pjesë e lëndës ishte gati për të dalë në treg, por dy shqiptarët nuk i shpëtuan dot arrestimit nga shërbimet e policisë britanike. Njëri prej tyre deklaroi para hetuesve se u jstë sasinë e kanabisit dhe për këtë paguhej 100 sterlina në ditë, por edhe këto nuk i kishte marrë dot nga pronarët e kanabisit. Njëri prej tyre tha se është i frikësuar për jetën e familjes pas arrestimit. "Pas arrestimit tim dhe shkatërrimit të bimëve të kanabisit jam i frikësuar për jetën e familjes sime në Shqipëri". Pas kryerjes së dëimit me 3 vite burg, të dy shqiptarët do të dëbohen nga Anglia për në Shqipëri.

Shitje me Ankand të trete nga Studio Permbartimore L.D.C

1. "Ndertese", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, Iqaz 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tufinë, Tiranë. Regjistruar në Zyren Vendore Regjistrimi Pasurive Paluajstme Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 leke.

Data e shpalljes 30.10.2018
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16.00

Ankand zhvillohet në ambientet e Studios Permbartimore L.D.C me adresë Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra permbartimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 28 dhjetor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyre permbartimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 9518, Pllazh, Durrës. Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithsej rreth 245 m²) dhe tre apartamente (gjithsej rreth 245 m²) dhe mbi këto prona nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 34.000 lek/m², ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 51.000 lek/m².

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G. Bailiff Service" me përmbartim gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruvoa, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 14.12.2018 ora 8.00 - 16.00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i I-rë për shitjen e pasurive të paluajstme, Truall me sipërfaqe totale 112 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 167/36, Vol.6, Fq.122, Zk.9518 në pronën të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.PK, me vlerë fillestare në ankand 11.648 (Njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) EURO dhe Pasuri e paluajstme, Truall me sipërfaqe totale 1260 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Durrës me Nr.pasurie 162/35, Vol.7, Fq.236, Zk.9516 në pronën të Shoqëria "ADRIATIKA BETON" Sh.PK, me vlerë fillestare në ankand 131.040 (Njëqind e tridhjetë e një mijë e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

BURGJET NE KOMUNIZEM HISTORIA

Ekskluzive/ Historia e panjohur e djaloshtit kuksian, nga radhët partizane, në Fakultetin e Mjekësisë në Bashkimin Sovjetik

Fadil Spahiu, mjeku i diplomuar në Moskë, që vuajti burgjeve të regjimit komunist

Artikulli i gazetës "Pravda" për studentin shqiptar, që mahniti profesorët rusë

Dashnor Kaloci

Fadil Spahiu është një nga ata dhjetëra shqiptarë që gjatë periudhës së regjimit komunist të Enver Hoxhës patën rastin të studionin në universitetet e vendeve të Europës Lindore, ku falë aftësive të tij u diplomua me rezultate të shkëlqyera dhe për të shkruanin gazetata me të mëdha të Bashkimit Sovjetik të asaj kohe. Pas diplomimit, ai u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi punën plot pasion, duke ëndërruar që të bëhej një mjek i aftë dhe t'u shërbente bashkatdhetarëve të tij me të gjitha mundësitë që kishte. Dhe ai fillimisht ia arriti kësaj, duke u bërë një nga mjekët më të njohur në Shqipëri, por ëndrra e tij papritur u këput në mes dhe "një ditë të bukur", ai e pa veten në pranga, në burgjet e regjimit komunist të Enver Hoxhës, i akuzuar si "agjent i sovjetikëve" etj., akuzat të montuara nga Sigurimi i Shtetit. Lidhur me këtë dhe në përgjithësi jetën e Fadil Spahiut, po ju njohim në këtë shkrim nga të dhënat që kemi mundur të mbledhim nga të afërmit e tij, pasi vetë Fadil, tashmë në moshën 92-vjeçare, nuk ka dashur dhe nuk ka pranuar kurrë që të flitet për të, edhe pse ka qenë një nga mjekët më njohur të Shqipërisë.

KUSH ËSHTË FADIL SPAHIU?

Fadil Spahiu ka lindur në Kolesjan të qarkut të Kukësit në vitin 1926, në një familje patriotike lumjane. I ati, Rifati, ishte burrë me emër në të gjithë krahinën e Lumës e më tej, një vazhdues i denjë i traditave atdhetare dhe arsime dashëse të fisit të vet. Kishte mbaruar shkollën Normale të Elbasanit dhe për vite me radhë ai punoi si arsimtar në qytete e fshatra të Shqipërisë. Rifati ka qenë kryetar i Këshillit të Qarkut të Kukësit menjëherë pas luftës (nëntor 1944), kur përfshihet nën juridiksionin e tij edhe Prizreni.

GJIMNAZIST NË SHKODËR, SHOK ME EMIN DURAKUN NË KONVIKTIN "MALET TONA"

Shkollën fillore Fadili e kreu në vendlindjen e tij dhe në vitin 1937 filloi studimet në gjimnazin e Shkodrës. Këtu ai shumë shpejt aktivizohet me grupet rinore të qytetit dhe merr pjesë në demon-



Fadil Spahiu

stratën e parë kundër pushtimit fashist më 28 nëntor 1939 dhe njihet me një nga organizatorët e saj, Emin Duraku. Aty bie në sy të autoriteteve për guximin dhe vendosmërinë e tij për të zhvilluar aktivitete antifashiste. Forcat qeveritare arrijnë t'i shpërndajnë demonstruesit dhe Fadil Spahiun së bashku me disa shokë të tjerë, midis të cilëve dhe nxënës të konviktit "Malet Tona" i arrestojnë. Ende kur ishte në vit të dytë, rreth 14-15 vjeç, e përjashtojnë nga shkolla dhe e përplasën në bircuat e burgut të Shkodrës. Prej këtej, me rreth 16 të arrestuar të tjerë e nisnin për në burgun e Tiranës dhe pas pak ditësh e çojnë në burgun e Burrelit. Babai i Fadilit, që në atë vit ishte mësues në fshatin Kastriot të Peshkopisë, kërkoi që t'ia sjellin të birin në konviktin e shkollës së fshatit. Fadilin e sjellin pranë të atit me detyrimin për t'u paraqitur çdo ditë në policinë e fshatit.

PËRJASHTOHET NGA TË GJITHA GJIMNAZET SI ANTIFASHIT DHE DEL PAR- TIZAN

Në pranverë të vitit 1940 në gjimnazin e Shkodrës fillon një revoltë brenda shkollës, ku nxënësit kërkojnë kthimin e 16 shokëve të tyre, që ishin arrestuar në demonstratë. Kishin kaluar rreth 3-4 muaj dhe Fadilin e kthejnë në bankat e shkollës. Këtu përfundon vitin e dytë. Për të shmangur kontaktet e tij me elementë revolucionarë të qytetit, atë e nisnin për në Gjirokastrë që të vazhdojë vitin e tretë. Këtu ai shumë shpejt bëhet anëtar i organizatës antifashiste të rinisë gjirokastrite dhe vihet në krye të protestave antifashiste, që u bënë në Gjirokastrë më 28 nëntor

1941. Për këtë arsye, në fund të vitit 1941 Fadilin e përjashtojnë nga të gjitha shkollat e Shqipërisë pa e mbaruar vitin e tretë të gjimnazit. Kështu detyrohet të largohet nga Gjirokastra për të shmangur një arrestim të dytë dhe nisjet për në vendlindje. Me ndërhyrjen e prindërve shkon në Prishtinë tek disa miq të babait që të vazhdojë gjimnazin, por edhe këtu ai fillon sërish aktivitetin revolucionar, duke shtypur dhe shpërndarë trakte të organizatës së Partisë Komuniste të Prishtinës. Kur ky aktivitet bie në sy të organeve shtetërore, ai detyrohet të kthehet në vendlindje, ku sapo është krijuar çeta e Lumës dhe aty regjistrohet si partizan i saj. Më pas, Fadili kaloi si efektivi i batalionit të Lumës dhe luftoi në këtë formacion partizan deri në çlirimin e kryeqytetit, Tiranës më 17 nëntor 1944. Menjëherë mbas çlirimit të Tiranës, ai punoi si anëtar i Komitetit Qarkor të Rinisë Antifashiste të Kukësit. Në verën e vitit 1945 vjen në Tiranë për të ndjekur kursin veror që organizohet në shkollën "Nëna Mbretëreshë" me nxënës që i kishin humbur vitet e gjimnazit. Këtu mbaron vitin e tretë, ndërsa vitin e katërt e përfundon në Gjirokastrë, duke marrë diplomën në maj të vitit 1946. Mbas pjesëmarrjes si vullnetar për ndërtimin e hekurudhës Brčko-Banoviç në Bosnje, në shtator të vitit 1946, ai filloi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevo, në degën e Mjekësisë së Përgjithshme.

STUDENT I MJEKËSISË NË JUGOSLLAVI DHE NË BASHKIMIN SOVJETIK

Në vitin 1948, pasi u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë e

Titos, ende pa mbaruar akoma vitin e dytë, Fadilin së bashku me studentët e tjerë shqiptarë që ishin në Jugosllavi, i kthejnë në Shqipëri. Fillimisht i grumbullojnë në plazhin e Durrësit, ku presin të nisen sërish me studime, por këtë herë duke i dërguar në Bashkimin Sovjetik, në qytetin Gorki. Ishkolegë dhe shokë të tij tregojnë se Fadili ishte student që binte në sy për karakterin e tij, ai ishte tepër i zellshëm dhe aktiv në mësim. Duke parë aftësitë dhe këmbënguljen e tij për të mësuar gjithçka, mjekët pedagogë e aktivizojnë në operacione në Institutin e Kirurgjisë Restauratore që merrej kryesisht me invalidët e luftës dhe traumat e tyre. Fadili si student ishte më i miri. Pedagogët, që ishin shëfafa klinike, vazhdimisht e marrin secilin në klinikën e vet duke i beaur operacione specialiteti, si ortoped, operacione në veshka, stomak dhe mushkëri, etj.

Në vitin 1953, ndërsa frekuentonte rregullisht studimet, profesori i tij, Bllolin, që ishte drejtor i përgjithshëm i institutit, i besoi dhe i propozoi temën shkencore mbi zëvendësimin e kyçeve me proteza metalo-plastike dhe këtë punë ai e ka kryer vullnetarisht, jashtë orareve të mësimave. Në vitin 1954, kur u diplomua si mjek, kishte arritur të kryente 8 eksperimente në qen duke zëvendësuar kyçin e gjurit të këmbës së pasme me protezë metalo-plastike të konstruktuar prej tij dhe të aprovuar nga këshilli shkencor i institutit. Ky institut aprovoi mundësinë e projektimit dhe aplikimit të kësaj proteze te njeriu. Udhëheqësi shkencor, prof. N. N. Bllolin, i dha me shkrim mendimin se realizimi i kësaj proteze te njeriu do të shërbente si një punim i mirëfillt shkencor për marrjen e gradës "Kandidat i shkencave të mjekësisë". Në përfundim të studimeve me rezultate shumë të mira në universitetin "Gorki"-j, Fadili diplomohet si mjek kirurg dhe në vitin 1953 kthehet në Shqipëri. Në fillim ai punon si mjek i përgjithshëm në pavionin e tretë të spitalit civil Tiranë, ku bie në sy puna e tij si kirurg. Ai kryente operacione të vështira dhe kjo bëri që emri i tij të bëhet i njohur shumë shpejt jo vetëm në Tiranë, por edhe në të gjithë Shqipërinë. Pas pak kohësh, ai transferohet në spitalin e Durrësit, ku kryen edhe këtu operacionet duke qenë mjek i përgjithshëm.

PROFESORËT RUSË E VLERËSOJNË SI "KANDIDAT I SHKENCAVE MJEKËSORE"

Rekomandim i profesorëve rusë influencoi pozitivisht tek udhëheqja e PPSH-së së asaj kohe në Shqipëri dhe kështu Fadili i jepet e drejta e kryerjes së studimeve të aspiranturës. Për këtë qëllim dërgohet në Moskë në Institutin Shkencor të Luftës kundër Kancerit pranë Akademisë së Shkencave Mjekësore të Moskës, ku punonte udhëheqësi i tij shkencor N.N.Bllolin. Në vitin 1956 ai realizon me sukses për herë të parë në botë, zëvendësimin e kyçit të bërë rryll me protezë të brendshme metalo-plastike tek njeriu, që ishte një ngjarje e rrallë për mjekësinë evropiane të kohës. Trupa pedagogjike e pranon dhe e vlerëson me nota maksimale këtë rezultat të ri të kirurgut shqiptar. Kështu, ai fitoi gradën e kandidatit të shkencave mjekësore. Përveç operacioneve ortopedike në këtë institucion, ai operon edhe të sëmurët me kancer. Në përfundim të studimeve 3-vjeçare në Moskë, në vitin 1957 ai kthehet në Shqipëri me titullin "Kandidat i Shkencave Mjekësore", titull të cilin në atë kohë nuk e kishte asnjë mjek tjetër shqiptar.

MJEK KIRURG NË SPITALIN E TIRANËS

Në vitin 1957, Fadili fillon punën si mjek kirurg në spitalin e Tiranës, me një besim dhe përvojë disavjeçare. Ai punoi me një dëshirë të veçantë për të krijuar repartin e ortopedisë dhe falë aftësive të tij e krijoi menjëherë atë dhe emërohet shefi i parë i kësaj klinike. Krahas punës në klinikë, ai shërbeu edhe si pedagog në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, ku ka dha lëndët e Ortopedisë dhe Onkologjisë. Pas dy vjetësh u krijua edhe Klinika e Onkologjisë dhe të dyja këto klinika ai i ka drejtuar deri në vitin 1965. Këto vite ishin vitet e suksesit më të madh në punën e tij dhe krahas kësaj, ai punoi edhe si kryeredaktor i Buletinit të Mjekësisë, që botoonte Fakulteti i Mjekësisë dhe anëtar i këshillit shkencor të universitetit. Në klinikën e Ortopedisë dhe të Onkologjisë që drejtonte Fadili filloi zbatimi i operacioneve në të gjitha nivelet, por kjo gjë nuk vazhdoi gjatë. Për të filluar të thurnin intriga e shpifje, të bënin raportime në organizatën e partisë. Ai po etiketohet si "armik i

"Corriere della Sera", jehonë ndryshimeve në kryeqytetin shqiptar: Revolucion në Tiranë

Mediat e huaja vijojnë t'u bëjnë jehonë ndryshimeve që kanë ndodhur 3 vitet e fundit në Tiranë, por edhe ta promovojnë atë si një destinacion turistik, që po merr vëmendje të zgjeruar në Europë. Gazeta e njohur italiane, "Corriere della Sera", e rendit Tiranën si destinacionin më të mirë për turistët italianë për festat e fundvitit, duke e cilësuar si një nga qytetet më të reja, me alternativën dhe kosto të ulët, në Europën e re. "Nga tregjet e vogla përreth pemës së madhe në Sheshin 'Skënderbej', tek ndriçimi i kudogjendur - shkruan gazetarja e njohur Fancesca Masotti - bën që Krishtlindja të ndihet kudo". Në suplementin e saj, "Corriere della Sera" evidenton nismën e ndërmarrë nga Bashkia e Tiranës për Pyllin Orbital për gjelbërimin e kryeqytetit, si dhe transformimin e sheshit "Skënderbej", Pazarit të Ri dhe Piramidës, që do të nisë së shpejti. Fancesca Masotti shkruan se "grisë dhe frikës së dhjetëvjeçarëve të regjimit komunist, Tirana i përgjigjet me ngjyra dhe shije të forta në rrugët e saj".

REVOLUCION NË TIRANË

Një fundvit me surpriza në kryeqytetin shqiptar, një qytet i ri dhe "low cost", që ndjek gjithë fantazi të ardhmen. Mes muzeve të rinj dhe rampave të "Skatebord-it" mbi simbolet e së shkuarës.

Nga Fancesca Masotti

Sfida e radhës ka nisur, prej nëntorit Tirana është zyrtarisht kandidata për Kryeqytetin Evropian të Kulturës 2024. Vjen si mirënjohje për një nga qytetet më të reja, alternative dhe "low cost" e Europës së re, që udhëheq një vend që ka si moto turistike "Go your own way". (Ndiq rrugën tënde. Udhëto sipas mënyrës tënde). Kryeqyteti shqiptar, ku mosha mesatare, siç e deklaroi kryebashkiaku Erion Veliaj është 27 vjeç, ka katërfishuar popullsinë në 20 vite, është në rritje ekonomike dhe po përjeton një revolucionin "e gjelbër". Nga shpëzimet e vogla (të bukura prej druri, ngjyrë bakri dhe alabastre) përreth pemës së madhe në sheshin "Skënderbej", tek ndriçimi i gjithëpërfshirë bëjnë që atmosfera e Krishtlindjeve të ndihet më shumë se kudo. E kuptueshme për një vend të dalë nga diktatura komuniste vetëm në fillim të viteve '90. Por, vlera e vërtetë e shtuar



e një fundjave në qytet është të ndjesh "urinë e saj për të ardhmen". Mes arkitekturës otomane, fashiste, komuniste, qiellgërvishtësve të rinj dhe gjelbërimit në zona dikur të braktisura.

MES BUNKERËVE DHE AROMAVE TË FORTA

Për ta kuptuar vërtetë Tiranën, duhet të kalosh nga Blloku. "Ish-lagja e ndaluar, e rezervuar në atë kohë për elitat e regjimit, sot është mbretëria e të rinjve", tregon

Alice Ophelia Taylor, shkrimtare, gazetare dhe aktiviste angleze, që prej një viti jeton këtu (blogu i saj thebalkanisto.com është ndër më të lexuarit në Ballkan). Atje ndodhet Galeria Fab, në pronësi të Fakultetit të Arteve, ku shpalolet krijeshmëria më e fundit dhe më e mira e artit të rrugës në Shqipëri, e promovuar nga administrata lokale me projekte të tilla si "MurAl", një bashkëpunim mes bashkisë dhe laboratorit të Leçes "Rruga 167/B", që në 2018-ën

bëri bashkë mjeshtër të muraleve italiane, franceze, serbe dhe uruguaiane. E mandej bare, pub-e, galeri arti dhe studio arkitekturore, të hapura nga ata që kanë ndjekur kurse në Londër apo Milano e që kanë vendosur të kthehen.

LUFTA KUNDËR SMOGUT

Prej qershorit, në qytet janë hedhur në qarkullim 4 mijë biçikleta të markës "Mobiike", përkrah biçikletave të



Kinematografia në zi, ndahet nga jeta aktori Luan Qerimi

Është ndarë nga jeta aktori Luan Qerimi, në moshën 89-vjeçare. Aktori ka qenë shumë i dashur për shikuesit, pasi ka luajtur mbi 70 role në teatër dhe kinematografi, por prej vitesh Qerimi u tërhoq nga jeta artistike. Edhe pse prania e tij me role ka munguar vitet e fundit, ai ka lënë kujtime të pashlyera në mendjen e shumë artdashësve. Aktori Qerimi ka luajtur në disa role, konkretisht si "Arturo Ui", "Otello", "Orët e Kremlin", "Gracka", "Vdekja e kalit", e shumë e shumë role të tjera. Ai lindi në Lushnjë, në 15 tetor 1929 dhe i hyri botës së aktrimit, fillimisht me lëvizjen amatore, për t'u aktivizuar në Teatrin e Ushtrisë, ku talenti i tij do të spikaste. Ish-te 25 vjeç, kur në vitin 1954 do të hynte në Teatrin Popullor, që ishte ëndrra e çdo të riu që dëshironte të bëhej aktor. Aktori i mirënjohur ka luajtur një sërë rolesh, duke spikatur në film edhe në teatër, ndërsa ai ka interpretuar edhe në film-in artistik. Që nga viti 1989, aktori tashmë i ndjerë mbante titullin "Artist i Merituar".



"EcoVolis", që ka startuar në 2011. Një ide e përkryer për një qytet të sheshtë dhe me dimër të butë. Projekti "Tirana 2030-TR030" parashikon një brez pyjesh përreth qytetit. Studioja holandeze "Mvrdv" parashikon gjithashtu rikonstruksionin e Piramidës, mauzoleumit famëkeq, i ndërtuar nga familja e diktatorit Enver Hoxha në vitin 1988. Njëherë bazë e NATO-s për luftën në Kosovë, pastaj klub nate dhe tani është një rigjetje për "skater" (patinazh). "Do të mbetet një hapësirë për të rinjtë", thekson kryebashkiaku 39-vjeçar. "Një qendër multifunksionale për edukimin teknologjik, me një teatër dhe një librari. Do të jetë gati për qershorin tjetër". Ndryshimi ndihet kudo në sheshin "Skënderbej", zemra e qytetit është rikonstruktuar dhe është kthyer në pedonale, duke mirëpritur koncerte falas. Përreth janë mbjellë qindra pemë. Për gazetarin Stephen Burgen, të gazetës angleze "The Guardian", e bukura e Tiranës qëndron në kaosin e saj, godina të viteve '40, të suvatuara me suva fosforeshente, xhami dhe kisha ortodokse. Pasqyrë e një his-

torie torture. Për të përmendur turin "Communist Tirana" (Tirana komuniste) të "Good Albania", do të thotë të vizitosh vendet që përdorshin për t'u shpëtuar sulmeve, si "BunkArt" dhe "BunkArt2", "Shtëpia e Gjetheve", që rrëfejnë aktivitetin e ish-policisë sekrete. Grisë dhe frikës së atyre dhjetëvjeçarëve, Tirana i përgjigjet me ngjyra dhe shije të forta në rrugët e saj. Këto elemente ndeshen të Pazarit të Ri, një pazar i rikonstruktuar në vitin 2017, në verilindje të sheshit "Skënderbej", ku gjen japrakë me oriz, të mbështjellë me gjethe dhe specia me gjizë. Po kështu, zbulohen shije të reja edhe në lokalet e tjera, si "Mullixhiu", apo në vendet ku gjithçka është bio dhe me prodhime lokale, si në Fishtë, një orë larg nga Tirana. Këtu, agroturizmi, si tek "Mrizi i Zanave" bën që lenda e prodhuesve të vegjël të kthehet në një kryevepër, duke shoqëruar vreshtarinë autoktone, si Kallmet Prestigj. Niset nga tradita antike, shpesh e varfër, për të kaluar tek tendecat e reja. Pak a shumë, si ky qytet./tvklan.al/



MJEKU POPULLOR




Ylli Merja:
Luftoni kancerin
me bimën e pelinit
të ëmbël

KESHILLA



Si të parandaloni
inflamacionin
e bajameve

KIM DRASA:



◆
Mjeku urolog
dhe seksolog:
85% e
rasteve,
dëmtime
kronike në
pjesë të
ndryshme në
trup

Përdorimi i tepërt i biçikletës shkakton impotencë

"Shfaqen çrregullime në traktin
urinar dhe prostatë"

7 bimët që ndihmojnë aktivitetin e trurit

Voltiza Duro

Mjeku urolog dhe seksolog: 85% e rasteve, dëmtime kronike në pjesë të ndryshme në trup

Kim Drasa: Përdorimi i tepërt i biçikletës shkaktonte impotencë

"Shfaqjen çrregullime në traktin urinar dhe prostatë"

Përdorimi i biçikletës është një mënyrë shumë e mirë për një jetesë të shëndetshme, por mund të shkaktojë edhe probleme seksuale, veçanërisht te meshkujt. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku urolog dhe seksolog, prof. dr. Kim Drasa tregon se pasojat e pedalimit të tepërt mund të çojnë deri në impotencë te meshkujt. Më tej, mjeku thekson se nga përdorimi i tepruar i biçikletës, deri në 85% të rasteve (meshkuj-femra) mund të pësojnë dëmtime kronike në disa pjesë të trupit si qafë, duar, kyçe të duarve, fundin e kurrizit (kërbishte), gjunjë dhe mollaqe (glutealet) ose zonën e trupit që rri mbi shalën e biçikletës.

Cilat janë përfitimet e përdorimit të biçikletës në shëndetin e njeriut? Biçikleta (çiklizmi apo pedalim) është një formë e aktivitetit fizik, e cila promovon shëndetin në mënyra të panumërta, duke rezultuar në reduktimin e të gjitha shkaqeve të mortalitetit, në individë të ndryshëm, të cilët/at përdorin biçikletën rregullisht. Biçikleta po shndërrohet në metodën popullore të transportit, për fizikulturë dhe kalimin kohës së lirë. **A shkaktonte dëmtime përdorimi i saj?**

Me gjithë benefitet e njohura, në të mirë të shëndetit, duhet të dini se përdorimi i tepërt i biçikletës shkaktonte edhe dëmtime trupore. Deri në 85% të rasteve (meshkuj-femra) nga përdorimi i tepruar i biçikletës mund të pësojnë dëmtime kronike në disa pjesë të trupit si në: qafë, duar, kyçe të duarve, fundin e kurrizit (kërbishte), gjunjë dhe mollaqe (glutealet) ose zonën e trupit që rri mbi shalën e biçikletës. Impakti i përdorimit të biçikletës mbi shëndetin seksual për shkak të presionit të zgjatur mbi zonën perineale (pjesa e poshtme e trupit, e cila rri mbi shalë) ka marrë vëmendjen e duhur dhe shumë studime kanë raportuar për efektet negative mbi organet seksuale. Pjesa më e madhe e studimeve janë bërë në ata persona, të cilët përdorin biçikletën në distanca të gjata. Për më tepër, studimet kanë raportuar edhe për dëmtime të tjera si simptoma në trak-

tin e poshtëm urinar, çrregullime të urinimit), prostatitis kronik (infeksion kronik të prostatës), sindromin e dhimbjeve kronike pelvike (CPPS), apo dhe strukturën e uretrës.

Cilat ishin metodat e përdorura gjatë studimit?

Fillimisht u bë rekurrimi i 14.333 çiklistëve anonimë. Në pyetësor u përcaktuan: tipi i biçikletës, tipi i shalës, këndi i shalës, frekuenca e veshjeve të mbushura, të shkurtra, gjatë pedalimit. Gjithashtu, u përcaktua koha që rri pa hipur në shalë, lartësia e timonit, tipi i sipërfaqes (tokës) ku ata pedalojnë/garonin. Gjithashtu, çiklistët u ndanë në dy grupe: çiklistë me intensitet të lartë të përdorimit të biçikletës (ata me mbi dy vite dhe më tepër se tri herë në javë, me një mesatare më tepër se 25 milje) dhe çiklistë me intensitet të ulët, përcaktuar si ata, të cilët nuk arrijnë kriteret me intensitet të lartë si çiklist.

Cilat ishin konkluzionet e arritura pas studimit?

Mbi katër dëmtimet madhore, të cilat shkaktohen tek përdoruesit e rregullt të biçikletës janë: disfunksioni erectile, mpirja e organeve gjentialeve, shfaqjen simptomat e traktit të poshtëm urinar si dhe striktura e uretrës. Pra, mund të themi se përdorimi i biçikletës shkaktonte impotencë? Kompresioni i strukturave neuro-vaskulare midis shalës së biçikletës dhe symphyzis pubika (pjesa e përparme e kockave të legenit), gjatë pedalimit të biçikletës, shkaktojnë rënien e fluksit të gjakut dhe si rrjedhojë e kësaj jep ulje të oksigjenimit të penisit dhe logjikisht kjo ndodhi negative rezultoni në disfunksion erectil apo impotencë (nuk forcohet penisi). Kjo është konfirmuar edhe nga shoqata amerikane e urologjisë (AUA), në kongreset vjetore të viteve 1998 dhe 1999, respektivisht, duke pranuar lidhjen dëmtesuese midis çiklizmit dhe disfunksionit erectile. Konkretisht, ky dëmtim u konstatua në 13% të 160 çiklistëve, të cilët pedalojnë në një tur 540 km. Për më tepër, ky dëmtim seksual u pa se zgjati më tepër se një javë dhe më tepër se një muaj, në



Mjeku urolog dhe seksolog, prof. dr. Kim Drasa

6.95% dhe 1.9%, respektivisht, mbasi çiklistët mbaruan këtë tur dhe ndenjen pushim. Përveç kësaj, pothuaj asnjë çiklist nuk pati simptoma të dëmtimeve seksuale, pas më pak se 200 km pedalimi, gjatë këtij turi. Kjo tregoi se presioni i krijuar midis shalës dhe organeve gjentiale nuk është i mjaftueshëm për të shkaktuar disfunksion erectile persistent, por përkundrazi, vetëm përkohësisht dhe në situatë ekstreme, pra në pedalim për distanca të largeta (siç janë turet). Studimet më të mëdha në numër të njerëzve, të cilët përfshihen në studime për meshkujt, kryhen nga studimi i meshkujve në plakje, në Massachuset ku janë krahasuar rastet e përdoruesve të biçikletës në dy ndarje: në ata përdorues të moderuar të biçikletës nën 3 orë dhe në ata përdorues sporti si çiklist, mbi tre orë. Ky krahasim tregoi se ka diferencë mes dy grupeve, në shkaktimin e probleme seksuale. Studimi 'Angles' për shëndetin në çiklizëm (5.282 çiklistë) konfirmuan se kanë probleme seksuale. **Si ndodh mpirja e organeve gjentiale nga pedalimi?**

Mpirja e organeve gjentiale është dëmtimi i dytë nga përdorimi i biçikletës. Ky konkluzion u arrit nga studimi transkutan i pre-

ajo mundet gjithashtu të shpjegojë burimin (shkaktarin) e avaris, dëmtimi të lëkurës, e cila tenton të ndodhi në labiat e vulvës (pjesa e jashtme e organeve gjentiale te gratë) duke krijuar nodule (kokrra) hyperplastike.

Si shkaktohen çrregullimet në traktin e poshtëm urinar nga përdorimi i biçikletës?

Simptomat e traktit të poshtëm urinar (LUTS) janë pothuaj të vërtetuara në përdoruesit e biçikletës, por edhe këto simptoma urinare (çrregullime) janë më të shprehura në ata përdorues me kohë më të gjatë të biçikletës. Striktura e uretrës është ngushtimi i tubit ku kalon urina, nga qafa e vezikës urinare deri në dalje-jashtë trupit. Përdoruesit e biçikletës me kohë të plotë ose të kufizuar (me intensitet të ulur përdorimi) kanë sinjifikatish shanset negative, më të larta për të pasur strikturë uretre, e cila klasifikohet të dëmtimet me serioze urologjike. Ky përfundim përforcohet pasi ata meshkuj, të cilët nuk përdorin biçikletën, nuk kanë asnjëherë dëmtime të uretrës deri në ngushtim (stricture) të saj. Prevalenca e strikturave uretrale bëhet më e lartë në pesë përqindshat e dytë dhe të tretë, të kohës së përdorimit të biçikletës. Striktura e uretrës është i vetmi përfundim në të cilën arrijnë, në unison, të gjitha studimet për dëmtimet nga përdorimi i rregullt i biçikletës. Mikro-traumat të përsëritura, me intensitet të ulët, në zonën gjentiale janë menduar si mekanizmi i shkaktimit të dëmtimeve të tepruara genitourinare. Burrat të cilët përdorin biçikleta me timon më të lartë se niveli normal i krahëve dhe duarve, kanë më pak rrezik për t'u shfaqur dëmtimet e mësipërme. Burrat të cilët përdorin biçikleta me timon në nivel më të ulët se shala, janë më të rrezikuarit për shfaqjen e katër dëmtimeve të mësipërme. Njerëzit, që nuk kanë mundësi ekonomike për të blerë biçikleta speciale, atëherë të bëjnë këto dy veprime: shalën ta ulin në maksimum, derisa e lejon lloji i biçikletës dhe timonin ta ngrënë në maksimum.



Voltiza Duro

Artemisia është ndër bimët më të përdorura në lashtësi, kundër kafshimeve nga kafshët e ndryshme. Bima ka lindur në Europën Jugore duke përfshirë Shqipërinë, Bullgarinë, Rusinë, Serbinë etj., dhe pastaj është përhapur edhe në Azi, Vietnam, Indi, Kinë etj. Artemisia është pjesë e familjes Asteraceae, bimë njëvjeçare, e cila rritet 30-100 cm gjatësi. Gjethet e bimës janë 3-5 cm dhe ndahen me gjethe të vogla. Aroma e fortë e bimës vjen nga Artemisina që përmban bima, dhe ndodhet nga 0-1.5%. Bimët e kultivuara mund të arrijnë deri në 2%. Artemisina mendohet se shkakton dëmtime në organizmin e parazitëve të ndryshëm dhe i shkatërron e madje prodhon radikale të lira, duke shkaktuar këputje në urat e endoperoxideve nga hekurit. Kjo prodhon radikale të lira, që çon në stres oksidues në qelizat e parazitëve dhe qelizat treten nga vetvetja dhe si pasojë ngordhin parazitët. Është përdorur në ilaçet që kurojnë malarien dhe sëmundje të tjera virale dhe bakteriale.

VETITË KIMIKE TË BIMËS
Artemisia annua L. është bimë barishtore njëvjeçare e gjinisë Artemisia, familja Asteraceae (Compositae). Rritet zakonisht në vende të thata ose gjysmë të thata. Njihet vetëm një varietet i kësaj specie. Pelini i ëmbël është një bimë shumë e studiuar kohët e fundit, sidomos për veprimin e saj mbi kancerin. Mendohet se lufton kancerin e gjirit, tiroideve, dhe leuçeminë. Vetitë antikancerogjene të bimës janë për shkak të përbërësit Artemisin dhe përbërësve që derivojnë nga ajo si dihydroartemisinin, arthemether, artheether dhe artesunate. Artemisia nëse përdoret 4-7 ditë, mund të përmirësojë këto simptoma: anoreksia, infeksione bakteriale, kolla dhe i ftohti, diarre dhe kapsllëk; probleme me stomakun dhe tretjen, psoriasis, tuberkulozin. Artemisia është shumë efektive kundër parazitëve dhe mykut në zorrë, Artesunate, një derivat i artemisinës ka qenë shumë efektive në kura kundër leuçemisë dhe kancerit në shtyllën kurrizore. Është vërtetuar eksperimentalisht efekti antiviral i artemisinës, pasi ajo ndalon qelizat e virusit të riprodhohen, ndalon që ai të lirojë ADN e tij në qelizën që pushon. Artemisina bllokun punën e

Mjeku popullor: Ndhmon për kurimin e të ftohtit, parazitëve dhe mykut në zorrë

YLLI MERJA:

Luftoni kancerin me bimën e pelinit të ëmbël

"Si të përgatisni çajin çudibërës, efektet në organizëm"

enzimave si Citokromoksidade në mitokondri në qelizat e baktereve dhe organizmave njëqelizore si Plasmodium.
PËRBËRËSIT FITOKIMIKË
Përbërësi kryesor i Artemisinës është një seskuiterpen. Përmbajtja e vajit eteror në pjesën mbitokësore të bimës është 0.2 - 0.25%. Përbërësi kryesor i vajit eteror është kamfeni. Janë të pranishëm edhe izoartemisinina ketone, kamfor, ?-pineni. Vaji esencial është rreth 3% në gjethet e bimës, por kërkime të mëtejshme duhen bërë për vetitë e kësaj bime. Këto përbërës i japin vetitë antibakteriale bimës.
Studimi i artemisinës për përdorim në kimioterapi
Mundësia e përdorimit të artemisinës në kimioterapi bazohet në ve-



Ylli Merja

Mendohet se lufton kancerin e gjirit, tiroideve, dhe leuçeminë. Vetitë antikancerogjene të bimës janë për shkak të përbërësit Artemisin dhe përbërësve që derivojnë nga ajo si dihydroartemisinin, arthemether, artheether dhe artesunate.

shpejt vetitë. Kjo bimë duhet hedhur në ujë të valuar. Dozimi i rekomanduar për bimën është 4.5-9 gramë në ditë për të rriturit, hidhet në ujë të valuar, lihet të qëndroje 5-6 minuta dhe pastaj konsumohet. Është mirë që të konsumoni 2 gota në ditë nga ky çaj.



primin e artemisinës me hekurin, i cili në qelizat kancerogjene ndodhet në nivele të larta. Nga provat e kryera është dalë në përfundim se dimerët dhe trimerët e artemisinës, të përfutur si molekula hibride të artemisinës me molekula të tjera, janë më veprues. Megjithatë, analogët e artemisinës janë më pak veprues sesa barnat e tjera citostatike.

KUJDES!

Gratë shtazëna dhe me fëmijë në gjë nuk duhet ta përdorin këtë bimë. Gjithashtu, njerëzit me diabet nuk duhet ta konsumojnë. Çaji i pelinit është i përbërë nga gjethet dhe lule prandaj nuk duhet valuar, pasi i degradohen shumë



Bajamet kanë funksion mbrojtës shumë të rëndësishëm në organizëm. Mirëpo, nëse shpesh apo vazhdimisht janë të pezmatuara, janë rrezik për organizmin dhe duhen hequr. Inflamacioni i bajameve vetvetiu kalon pas katër apo pesë ditësh. Mirëpo duhet shumë kujdes në qoftë se inflamacioni shpesh paraqitet nga fillimi, madje me qelbëzim, i shoqëruar me temperaturë të lartë. Në qoftë se inflamacioni i bajameve është kronik, pas një kohe mund të shkaktojë sëmundjen reumatike të nyjave dhe të zemrës apo të dëmtojë veshkat. Në raste të tilla operimi i bajameve është i domosdoshëm. Mirëpo, operacionin duhet bërë kur bajamet janë të zmadhuara dhe kur vështirësojnë përpirjen apo bëhen shkaktare të gërhitjes. Në raste të shumta si shkaktarë përmenden streptokokët e ndryshëm, stafilokokët, pneumokokët, adenoviruset, mikoizat etj. Fyti është vendi ku kryqëzohen sistemet e tretjes dhe të frymëmarrjes, të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me mjedisin e jashtëm. Në të janë të vendosura disa grumbullimesh indesh, që përngajnë me ato të gjëndrave limfatike. Një grumbull tjetër është i vendosur prapa hundës që janë aneidoidet, në gjuhën popullore quhen "mish në hundë", dy grumbullime të tjera janë të vendosura në dy anët e fytit, që janë tonsilit palatine ose "bajamet". Në rëndësi të gjatë është vendosur një tjetër grumbull indesh të tilla që quhet "bajamja" e gjuhës. Të katërta grumbullimet që thamë më lart luajnë një rol të rëndësishëm për organizmin e njeriut, sepse kontrollojnë çdo gjë që kalon në rrugën e ushqimit dhe të ajrit. Përveç funksionit që përmendëm, bajamet prodhojnë edhe disa qeliza të gjakut që quhen limfocide. Ato kanë veti mbrojtëse. Kur bajamet sëmurën, këto kthehen në qeliza gllabëruese për

mikrobet, duke i shkatërruar ato. Tjetër rol i rëndësishëm i bajameve është se këtu prodhohen të ashtuquajturat trupëza mbrojtëse (antikorpe), të cilat shkatërrojnë mikrobet dhe helmimet e tyre. Shkaktarë të shfaqjes së këtij shqetësimi janë mikrobet e ndryshme, që favorizohen nga i ftohti dhe nga ulja e rezistencës së organizmit. Shenjat e para të sëmundjes janë dobësi e përgjithshme, tharje dhe dhimbje fyti, temperatura që rritet deri në 38-39 gradë. Fëmijët e vegjël veç të tjerash refuzojnë ushqimin dhe ankohen shpesh për dhimbje barku. Ndërlikimet e anginave janë lokale dhe të përgjithshme. Kalimi në formën kronike të sëmundjes është ndërlikimi më i shpeshtë lokal që është quajtur tonsiliti kronik. Veç kësaj, mund të kemi grumbullimin e qelbit përreth bajames që quhet abces peritonsilar. Në qoftë se grumbullimi i qelbit bëhet në thellësi të qafës, quhet flegron dhe ky është ndërlikimi më i rëndë që shoqërohet me zmadhimin e gjëndrave limfatike në fyt. Ndërlikimet e përgjithshme të anginave janë reumatizma, sëmundjet e veshkave dhe të zemrës. Shenja



kryesore e kësaj sëmundjeje është dhimbja, vështirësi në gjëllitje dhe të folurit karakteristik sikur ka diçka në gojë. Tonsiliti kronik shpesh nuk ka shenja të qarta, por vetëm një shqetësim të papërcaktuar në grykë, nganjëherë vështirësi në gjëllitje, kur bajamet janë shumë të zmadhuara, si dhe erë të keqe nga goja. Disa të sëmurë kanë ngrije të lehtë të temperaturës, që nganjëherë mund të vazhdojë për shumë kohë. Shenjë më e sigurt për një tonsilit kronik është shfaqja e anginave të shpeshta, të shoqëruara dhe me rritjen e gjën-

drave limfatike të fytit dhe të qafës.
A DUHEN OPERUAR BAJAMET?
Pyetjes nëse duhen operuar bajamet, ende shkenca sot nuk i ka dhënë një përgjigje plotësisht të saktë. Bajamet në përgjithësi operohen pas moshës 3 vjeç, me ndonjë përjashtim të veçantë dhe përpara kësaj moshë. Bajamet hiqen kur sëmurën shpesh, ose kur formojnë vatër infeksioni për sëmundje të ndryshme. Ndodh që bajamet të jenë të zmadhuara, por nuk do të thotë se duhen hequr si të sëmura, pran-

daj këto lloj bajamesh hiqen vetëm atëherë kur ato japin shqetësime të tilla si dhimbje veshësh apo ulje të dëgjimit, zmadhim të gjëndrave limfatike të qafës, fytit, vështirësi në frymëmarrje, në gjëllitje dhe të folurit e fëmijës.
PARANDALIMI
Bajamet janë barriera e parë për mikrobet që hyjnë në organizëm dhe vendi ku asgjësohen pa kaluar më tej në organizëm. Kjo është arsyeja që personat që kanë hequr bajamet preken shpesh dhe shpejt nga faringit. Së pari, mjekët këshillojnë që për fëmijët e predispozuar për t'u prekur nga bajamet të tregohet një kujdes maksimal ndaj veshjes, qëndrimin në ambientin e jashtëm, sidomos në ditët e ftohta, por edhe në ato të nxehta, pasi fëmija nga lëvizja e tepër mund të djersitet shumë dhe kjo bëhet shkak për ftohje. Gjithashtu, duhet të përdoren ushqime dhe pije në një temperaturë normale. Në të njëjtën kohë mund të këshilloja kufizimin në maksimum nga fëmijët të pijeve të gazuara si "Coca-Cola", sidomos kur kanë bajame të sëmura (të skuqura, të qelbëzuara), sepse këto pije mund të përkeqësojnë stadin e sëmundjes.

KËSHILLA

për parandalimin e inflamacionit të bajameve

Këshilla



7 bimët që ndihmojnë aktivitetin e trurit

Aktiviteti i trurit është unik tek çdo individ dhe mund të krahasohet me gjurmët e tij të gjshave. Kur njeriu zgjohet nga gjumi, truri i tij arrin të prodhojë njaftueshëm elektricitet sa të ndezë një llambë të vogël. Truri është organi me përmbajtjen më të madhe yndyrore, që arrin deri në 60%. Kjo është arsyeja përse një regjim ushqimor i pasur me acide yndyrore, siç janë omega-3 dhe omega-6 është thelbësor për shëndetin e trurit. Përveç acideve yndyrore, truri ka nevoja të mëdha, të cilat plotësohen edhe nëpërmjet barishteve dhe erëzave. Më poshtë po listojmë disa nga bimët dhe erëzat më të mira për trurin tuaj.

TRENDAFILI I EGËR
Kokrrat e trëndafililit të egër janë nga bimët medicinale me efektet më të fuqishme në organizmin e njeriut. Trëndafilili i egër është një nga elementët që duhen përdorur në mekanizmat mbrojtës të trupit. Mund ta përdorni si çaj, duke shtypur 4-5 kokrra trëndafilili të egër e t'i zieni më pas në një

gotë ujë.

SHEREBELA
Sherebela është një bimë mjekësore shumë e mirë për kujtesën. Studimet më të fundit mjekësore kanë konfirmuar se sherebela është e rëndësishme për shëndetin e njerëzve që vuajnë nga Alzheimeri.

Sherebelën mund ta konsumoni në formën e çajit, duke zierë në një filxhan çaji ujë 7-8 gjethe të freskëta sherebele ose 2 lugë çaji gjethe të thata. Nëse preferoni, mund ta ëmbëlsoni me mjaltë.

BARI I BLETËS
Sipas të dhënave, bari i bletës është një barishte shumë e mirë për përmirë-



simin e funksionit dhe aftësi të trurit. Ai rekomandohet edhe kundër ankthit dhe pagjumësisë.

KANELLA
Kjo erëz e superfuqishme përmban shumë antioksidantë. Ajo lufton inflamacionin dhe e bën njeriun më të vëmendshëm dhe vigjilent. Thjesht aroma e kanellës ka aftësi të përmirësive funksionet e trurit. Ajo konsiderohet si një element i mirë në trajtimet kundër sklerozës. Mund ta përdorni në çaj.

PIPERI I ZI
Piperi i zi përmban piperinë, një substancë natyrale që përmirëson funksionin e trurit dhe zbut simptomat e depresionit.

MAJDANOZI DHE TRUMZA
Këto barishte përmbajnë apigeninë, e cila është shumë e rëndësishme për formimin e neuroneve. Sipas studimeve, rekomandohet përfshirja e tyre si çaj në trajtimet kundër depresionit dhe Alzheimerit.

ROZMARINA
Aroma e rozmarinës i jep shtytë pozitive trurit me një nuhatje të vetme. Acidi karbosik, që është përbërësi aktiv i rozmarinës e mbron trurin nga radikalet e lira dhe nga ishemia.



Efektet e mrekullueshme të kurës me limon e hudhër

Kura me limon dhe hudhër është efikase në eliminimin e depozitave të yndyrës në organizëm. Këto përbërës ulin kolesterolin e keq dhe pakësojnë numrin e triglicerideve në gjak. Limoni dhe hudhra parandalojnë trombozën, ulin tensionin e gjakut dhe përmirësojnë funksionet e mëlçisë dhe aftësinë e saj për të pastruar gjakun. Për më tepër, limoni me hudhrën përmirësojnë funksionin e veshkave dhe qarkullimin e gjakut. Sistemi imunitar është më i fortë, ndërkohë që hudhra dhe limoni parandalojnë radikalet e lira. Qelizat janë më të mbrojtura dhe plot gjallëri falë antioksidantëve që gjenden tek limoni dhe hudhra. Kura pastruese rekomandohet për të parandaluar sëmundjet, ose për të pastruar organizmin. Ajo duhet shfrytëzuar një herë në vit. Kjo kurë është shumë e dobishme nëse vuani nga: mbipesha, ishemia, sinoziti, sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes, dhimbjet e kokës, artriti, reumatizma, gastriti, hemorroidet, problemet me shikimin dhe dëgjimin, anemia. Për kurën me limon dhe hudhër ju nevojiten: 4 limonë, 4 thelpinj hudhër, 3 litra ujë të zier të ngrohtë. Zgjidhni limonë organikë që të përdorni agrume me gjithë lëkurë të pastër dhe të paprekur nga pesticidet. Qëroni hudhrat, merrni 4 thelpinj dhe ndajini thelbinjtë në gjysma. Lajini limonët me ujë të bollshëm dhe priji në copa të vogla. Hidhni në një enë me ujë të ngrohtë të zier paraprakisht dhe të gjithë masën ndajeni në kavanozë qelqi. Mbyllini kapakët dhe futini në frigorifer për tri ditë. Më pas, kullojeni lëngun dhe futeni sërish nëpër kavanozë në frigorifer. Në ditët e para duhet të merrni nga një lugë gjelle gjysmë ore përpara çdo vakti. Nëse nuk vini re ndonjë efekt anësor, atëherë duhet ta rrisni dozën në dy lugë e më shumë deri sa të arrini të konsumoni 50 ml tri herë në ditë. Kjo kurë duhet të zjasë për 40 ditë dhe është pastruese dhe në ditët e para mund të përballeni me simptoma si sekreciona ose dhimbje koke, të cilat janë normale sepse tregojnë se trupi po largon toksinat.

Me 67 vota "pro", Kuvendi miraton 4 ndryshimet kushtetuese

Maqedoni, votohet draft-amendamenti për ndryshimin e emrit

Hapet "drita jeshile" për integrimin në BE dhe NATO

Kuvendi i Maqedonisë ka votuar ditën e djeshme draft-amendamentin për ndryshimin e emrit. Me 67 vota 'pro', 23 'kundër' dhe 4 'abstenim', Kuvendi dje votoi draft-amendamentet kushtetuese për ndryshimin e emrit. Në amendamentin e parë parashikohet që në Kushtetutë emri Republika e Maqedonisë të zëvendësohet me fjalët Republika e Maqedonisë së Veriut. Mediat maqedonase raportojnë se qëllimi i këtyre ndryshimeve kushtetuese është implementimi i Marrëveshjes me Greqinë, e cila duhet të mundësojë integrimin të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Hyrja në fuqi e amendamenteve kushtetuese do të nisë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të nënshkuara me rezolutën 817 (të vitit 1993) dhe 845 (të vitit 1993) në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për ndërprerjen e vlefshmërisë së Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik të të dyja palëve dhe ratifikimin e protokollit për anëtarësimin në NATO nga Republika e Greqisë. Si përfaqësues të qeverisë do të jenë kryetari, Zoran Zaev; zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë, Nikolla Dimitrov. Më 11 nëntor, në Komisionin për Çështje Kushtetuese përfundoi diskutimi dhe iu dha dritë jeshile katër draft-amendamentet kushtetuese të Maqedonisë. Diskutimi dhe miratimi i draft-amendamenteve në komisionin kuvendar dhe votimi i dytë vjen pas fazës, që rezultoi me hapjen e Kushtetutës së Maqedonisë, më 19 tetor të 2018-ës, në Kuvendin e Maqedonisë, që u mundësua me votën "pro" të 80 deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë, përfshirë edhe 8 deputetë të VMRO-DPMNE-së, të cilët pasi që u përjashtuan nga partia, në Kuvendin e Maqedonisë vepron në kuadër të grupit parlamentar të pavarur, për të cilin u formua Komisioni për Pajtim National. Ndërkaq, kujtojmë se me 69 vota pro dhe asnjë kundër apo abstenim, në Kuvendin e Maqedonisë u ratifikua marrëveshja e emrit me Greqinë në fund të shtatorit. Në fjalimin në fillim të seancës plenare, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev deklaroi se me ratifikimin e marrëveshjes së emrit me Greqinë ruhet identiteti shtetëror dhe kombëtar i Maqedonisë, ndërkohë që tha se, "duhet të bashkohemi që në Bruksel të valojë flamuri i Maqedonisë. Me këtë vendim, jo vetëm fitojmë një mik, partner strategjik; jo vetëm që garantojmë edhe sigurinë, por realizojmë edhe aspiratën shekullore të paraardhësve tanë, që përfundimisht të pranohet në botë një shtet në të cilën flasin gjuhën maqedonase. Për këtë çështje të rëndësishme", tha Zaev pas përfundimit të nënshkrimit të marrëveshjes. Ratifikimi i marrëveshjes së emrit me Greqinë vjen si "dritë jeshile" për anëtarësimin e Maqedonisë në BE dhe përmirë-



simit të marrëdhënieve me ndërkombëtarët. Ndërkohë që kujtojmë se vetëm një muaj më parë qeveria e Maqedonisë pas shumë debatoje ia ka dalë që të miratojë nismën për ndryshimet kushtetuese që i hapin rrugë ndryshimit të emrit nga Republika e Maqedonisë, në Republika e Maqedonisë së Veriut. Nisma u miratuar me 80 vota pro dhe 39 kundër. Shumica qeverisëse nuk i kishte votat e mjaftueshme, por rrjedhja nga

opozita solli miratimin e marrëveshjes me Greqinë. Tetë ish deputetë e VMRO DPMNE-së, që votuan pro ndryshimeve kushtetuese, që i hapin rrugë emrit të ri të Maqedonisë, por edhe integritet në NATO. Deputetët e opozitës që votuan "pro" janë Vlado Aviroviç, Sashe Vasilevski, Elizabeta Kançevska-Milevska, Kërste Mukovski, Emilija Aleksandrova, Ljuben Arnaudov, Nola Ismailovska dhe Zeqir Rançilloviç.

KATHIMERINI YANNIS BASSIAS

"Disa kompani kanë teknologji dhe njohuri për të kërkuar në thellësi të detit Jon dhe Kretës, ndërsa teknologjia që do të lejojë shpime në thellësi më të mëdha se 3.000 metra pritet të jetë në dispozicion atëherë kur të vendoset nëse prodhimi i naftës dhe gazit është në të vërtetë i realizueshëm", tha presidenti i 'HHRM'.



Taksa 100%, Serbia mbyll terminalin doganor në Preshevë

Qeveria e Serbisë ka mbyllur dje terminalin doganor në Preshevë, duke e zhvendosur në Vranjë, 40 kilometra larg kufirit. Vendimi në fjalë erdhi me arsyetimin se ka rënë importi dhe eksporti. Mediat kosovare raportojnë se mbyllja e këtij terminali ka ngjallur reagime në Luginën e Preshevës. Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Serbisë, Bordi i Doganave bëri të ditur se do të mbyllet Terminali doganor në Preshevë. Besnik Sadiku, kryeshf i shërbimit të Financave në Komunitet e Preshevës, e ka vlerësuar të dëmshëm mbylljen e terminalit doganor.

Kërkim për naftë e gaz në Jon, Greqia gati 500 mln euro investim

Për 7-8 vite, kompanitë e hidrokarbureve, shpime në det në thellësi deri në 3 mijë metra



Kompanitë që kërkojnë naftë dhe gaz në tokë dhe në det në pjesën perëndimore të Greqisë do të investojnë 500 milionë euro në 7-8 vitet e ardhshme, sipas kreut të kompanisë shtetërore që negocion licencat e eksplorimit. Sipas gazetës "Kathimerini", Yanniss Bassias, president dhe drejtor ekzekutiv i menaxhimit të "Hellenic Hydrocarbon Resources" (HHRM) foli për madhësinë e investimeve dhe mundësitë që ofron Greqia në Forumin e Fundit të Mesdheut Lindor mbi

ligjin e energjisë të organizuar në Athinë. Bassias theksoi se disa kompani kanë teknologji dhe njohuri për të kërkuar në thellësi të detit Jon dhe Kretës, ndërsa teknologjia që do të lejojë shpime në thellësi më të mëdha se 3.000 metra pritet të jetë në dispozicion në atë kohë kur do të vendoset nëse prodhimi i naftës dhe gazit është në të vërtetë i realizueshëm. Pra, Greqia do të shërbejë si një terren provues për teknologjinë e re. Ndërsa kapaciteti i Greqisë përëndimore, në perëndim

të Korfuzit për të prodhuar hidrokarburet është duke u hulumtuar, rezerva të provuara janë gjetur në detin Mesdhe midis Qipros, Egjiptit dhe Izraelit dhe në Detin e Zi. Parlamenti grek pritet të ratifikojë kontratat e licencimit për eksplorimin e hidrokarbureve në detin Jon, në perëndim dhe në veriperëndim të Kretës. Ajo që do të pasojë është një përpjekje për të bindur kompanitë që të shikojnë fushat, të cilat ende nuk kanë tërhequr interesin e investitorëve.

Rritja e taksës së naftës, "jelekët e verdhë" përplasen me policinë në Paris

Protestat për karburantin, Macron mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme

Pa lider në krye, vijnë dëmet e mëdha materiale nga të rinjtë

Pas vijimit të protestave në kryeqytetin e Francës, presidenti francez, Emmanuel Macron ka konsideruar të shpallë gjendje të jashtëzakonshme për të parandaluar përsëritjen e protestave të dhunshme si dhe ka bërë thirrje për bashkëbisedim me protestuesit. Grupe të të rinjve me maska në fytyrë, si dhe mjete të forta kanë protestuar në rrugët e Parisit, duke shkakuar dëme të mëdha materiale në makina dhe ndërtesa. "Duhet të mendojmë për veprimet që duhet të ndërmerim për të mos përsëritur këto incidente", tha Griveaux. Autoritetet u zunë në befasi nga përshkallëzimi në dhunë pas dy javësh protesta në të gjithë Francën kundër ngritjes së taksës së naftës. Presidenti Emmanuel Macron do të mbajë një takim me kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm francez për të diskutuar rreth protestave dhe dialogut të mundshëm me protestuesit të njohur si "xhaketat e verdha", që nuk kanë lider apo udhëheqës, por u mobilizuan përmes rrjeteve sociale. Protestat filluan më 17 nëntor dhe shumë shpejt u rritën në numër, duke bllokuar rrugët në të gjithë Francën si dhe qarkullimin në shumë vende publike. Ndërkaq të shtunën, për të tretën fundjavë radhazi, Parisi shndërrohet në betejë përplasjesh mes protestuesve dhe policisë. Më shumë se 5500 manifestues të njohur si "jelekët e verdhë" pushtuan rrugët e kryeqytetit francez, në protestën kundër rritjes së çmimit të karburantit. Mbi 100 prej tyre u arrestuan. "Harku i Triumfit" në shëtitoren "Champs-Élysée" u kthye në qendrën e përleshjeve mes protestuesve dhe policisë. Forcat e rendit përdorën gaz lotsjellës dhe ujin me presion për shpërndarjen e turmës. Manifestimet janë shtrirë në të gjithë Francën, ku mbi 30 mijë protestues kanë bllokuar aksent kryesore rrugore dhe autostradat. Ata kërkojnë anulimin e masës së ndërmarrë nga presidenti Emmanuel Macron. Mëshitetje për "jelekët e verdhë" erdhin edhe nga Brukseli, ku qindra protestues u përplasën me policinë dhe dogjën disa



FILLIMI I PROTESTAVE

Protestat filluan më 17 nëntor dhe shumë shpejt u rritën në numër, duke bllokuar rrugët në të gjithë Francën si dhe qarkullimin në shumë vende publike. Ndërkaq të shtunën, për të tretën fundjavë radhazi, Parisi shndërrohet në betejë përplasjesh mes protestuesve dhe policisë. Më shumë se 5500 manifestues të njohur si "jelekët e verdhë" pushtuan rrugët e kryeqytetit francez, në protestën kundër rritjes së çmimit të karburantit. Mbi 100 prej tyre u arrestuan. "Harku i Triumfit" në shëtitoren "Champs-Élysée" u kthye në qendrën e përleshjeve mes protestuesve dhe policisë.

makina në rrugët e kryeqytetit belg. Ndërkaq, kujtojmë se në 17 nëntor, rreth 300 000 "jelekët e verdhë", të emërtuar kështu për shkak të xhaketave fosforeshente që mbajnë veshur, mbushën rrugët dhe autostradat e vendit, aeroportet dhe tunelet. Të furishëm ndaj planit të qeverisë për të rritur taksat e karburantit në janar, ata arritën të bllokonin, kryesisht me barriera metalike, më shumë se 2 000

rampa hyrjeje, rreth-rrotullime dhe ura. Pasoja që rezultuan nuk ishin të mëdha, (së bashku me kaosin në trafik pati më shumë se 400 lëndime dhe një vdekje) por edhe politike. Të shtunën që pasoi, ai që organizatorët e kishin cilësuar si akti i dytë, ndodhi. Në vend që të ngriheshin bllokada nëpër Francë, ata e bënë Parisin qendër të takimit të tyre. Megjithatë qeveria u dha atyre leje për të përdorur "Champ de

Mars", parkun e madh të kufizuar nga Kulla Eifel dhe Les Invalides, protestuesit morën një drejtim tjetër të njohur, që u ishte ndaluar "Champs-Élysées". Ndërkohe që shumica dërrmuese e 8 000 apo më shumë protestuesve ishin paqësorë, disa grupe ose hajdutë e shndërruan zonën historike në një fushë beteje me policinë. Kur retë e gazit lotsjellës dhe ato të tymit të barrikadave në flakë u shpërndanë, republika qëndronte akoma në këmbë, por pasojat e kanë lënë qeverinë të tronditur, kur për më tepër organizatorët kanë bërë thirrje për aktin e tretë të së shtunës së ardhshme. Në mënyrë të parashikueshme, Macron dhe ministrat e tij i janë referuar të kaluarës, në mënyrë që të kapin ose izolojnë natyrën e kësaj lëvizjeje. Në ditët që prinin protestën, Macron paralajmëroi vendin kundër një "forme bashkëkohore të poujadizmit". Termi i referohet një lëvizjeje populiste që shpërtheu papritmas në vitet 1950 në Francë dhe u drejtua nga Pierre Poujade, një tregtar i vogël me zë të fortë nga pjesa rurale e Francës. Antirepublikan, antisemite dhe kundër taksave, ilaçi i tij për sëmundjet që kishin prekur Francën rurale ishte "Sortez les sortants" ose "Hidhi përjashta të braktisurit!". Me gjithë fillimin premtues në vitin 1956, kur

fitoi disa vende në parlament, partia e Poujades u dëshmtua jetëshkurtër. Në vitin 2003, Poujade vdiq në errësirë - aq keq sa që një prej "jelekëve të verdhë" është shprehur pas vërtjeteve të Macronit se ai duhet ta kërkonte emrin e Poujades në fjalor. Megjithatë Macron pretendon se e kupton zemërimin që nxit këto protesta, ai gjithashtu duket sikur synon dënimin e "jelekëve të verdhë". E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Bernard-Henri Lévy, i cili ka bërë një krahasim historik të vetin. Në një artikull për "La Règle du jeu", ky intelektual mbarëkombëtar i së matjes sugjeron se trazirat e 6 shkurtit 1934 i parashikojnë ngjarjet e së shtunës së kaluar. Në atë natë fatale, disa lëvizje nacionaliste ekstreme të djathta, më së shumti aksioni francez i Charles Maurras, u kombinuan dhe marshuan në Dhomën e Deputetëve. Duke u frikësuar nga një grusht shteti fashist, qeveria u përgjigj me forcë vdekjeprurëse; betejat që pasuan në rrugë lanë 16 protestues të vdekur dhe mijëra të plagosur. Për Lévy-n, sloganet e vitit 1934 dhe ato të vitit 2018 janë të ngjashme, të parat me thirrje për të marshuar në Dhomën e Deputetëve, të fundit për të marshuar në Pallatin Elysee. "Ky është një moment dhe mentalitet, që mund të lindë monstra", përfundon ai.

ZËDHËNËSI I PRESIDENTIT

"Presidenti francez, Emmanuel Macron ka konsideruar të shpallë gjendje të jashtëzakonshme për të parandaluar përsëritjen e protestave të dhunshme si dhe ka bërë thirrje për bashkëbisedim me protestuesit", ka thënë zëdhënësi Benjamin Griveaux.



Iran, prezantohet arma e re shkatërruese

Ditën e djeshme, në një ceremoni të transmetuar direkt në televizionin publik, kjo armë u bë pjesë e ushtrisë së Iranit në një bazë në Bandar Abbas. Shkatërruesi i quajtur Sahand, ka një kuvertë për helikopterë, lëshues raketorë, anti-sulmues ajror dhe anti-sulmues nga anijet. Irani ka çuar pajisjen e parë shkatërruese më 2010 në Gjirin Persik. Raportohet se Irani posedon edhe pesë të tjerë. Më 20 nëntor, ushtria iraniane ka njoftuar për blerjen e dy nëndetësve për misionet në ujë dhe ushtrisë së Iranit në kohën kur marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara janë tensionuar, pas rikthimit të sanksioneve që ishin tërhequr me marrëveshjen bërthamore të vitit 2015. Presidenti amerikan, Donald Trump, kishte thënë se marrëveshja është tërhequr për shkak të ndikimit të Iranit në Siri, Jemen, Liban dhe Irak si dhe krijimit të armëve bërthamore.

Opinion i Ditës

Për diplomacinë kulturore në Bruksel

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... autobusi i Institutit Kulinar "Neraxhi", që kishte zbarkuar nga Tirana për një minipanair gastronomik, prirë nga flamuri ynë kombëtar. Një nismë modeste, por pozitive e ministrit të Diasporës, Pandeli Majko, që kërkon përpunim dhe mbështetje të mëtejshme.

Përpara saj, ambasadorja Suela Janina organizoi pritjen tradicionale për trupin e huaj diplomatik. Këtë radhë ishin ftuar nga Tirana "delikatosa" të muzikës sonë elitare. Ambasadorë, europarlamentarë, zyrtarë të lartë belge e të tjerë u mrekulluan me këngët tradicionale dhe të repertorit të huaj të interpretuar me mjeshtëri të lartë nga dy elitare të muzikës sonë klasike, Vikena Kamenica dhe pianistja Merita Tërshana.

Ndërsa më 28 Nëntor, Ditën e Flamurit bashkatdhetarët tanë festuan në "shtëpinë e tyre", në selinë e Misionit tonë pranë BE-së mes ritmit të këngëve dhe valleve popullore dhe pak kuzhinë shqiptare. Mbrerat nga këto prijte të shoqëruara me kulturë mbeten për shumë kohë dhe shpesh takimet/bisedat diplomatike hapen pikërisht me këto kujtime të pashlyeshme kulturore.

Prandaj është i gabuar mendimi se pritjet për festën janë rutinë diplomatike, pa ndonjë vlerë kulturore dhe imazhi për vendin.

Ndaj, po veprohet drejt që fondi i destinuar për Festën Kombëtare por rivendoset sërisht, aq më tepër kur ndikimi i tij në financat e MPJ-së është i papërfillshëm. Gjithsesi, kjo do plotësojë më tej me furnizimin të pakët të disa prej përfaqësive kryesore diplomatike me sasi pjesëtona tradicionale dhe delikatesa kulinare, për t'i bërë plotësisht "shqiptare" këto dhe të tjera veprimtari. Sepse sot, kulinaria dhe pijet janë bërë "ingredient" i domosdoshëm i diplomacisë kulturore. Kjo e fundit shton efektivitetin dhe besueshmërinë e aktivitetit tonë diplomatik, ajo zgjeron praninë e të huajve dhe për rrjedhojë, kontaktet fizike që në diplomaci, pavarësisht nga rritja e rolit të dixhitalizimit mbeten jetike.

Ja pse ambasada/misioni pranë BE-së në Bruksel e kanë vlerësuar dimensionin kulturor, jo si shtojcë apo luks, as thjesht si argëtim e dëfrim, por si një faktor jetik për realizimin e objektivave madhore diplomatike dhe në radhë të parë, të çeljes së negociatave të anëtarësimit. Kultura ka pjesën e vet të ndjeshme në suksesin e punës së saj dhe më konkretisht për rekomandimin e Komisionit dhe të Parlamentit Evropian për çeljen e këtyre negociatave, krahas Belgjikës dhe Luksemburgut, që kjo Përfaqësi mbulon; ndonëse ka "portofolin" më të gjerë dhe ngarkesën më të madhe, me një personel prej dy vetash për pjesën e ambasadës dhe vetëm shtatë për misionin pranë BE-së. Pavarësisht nga



mungesat financiare, në vend të qarjeve dhe ankesave, në bashkëpunim me pushtetin lokal belg dhe komunitetin tonë, ajo ka shfrytëzuar mundësitë, duke konkurruar denjësisht me vendet e tjera dhe fqinjët tanë, edhe pse këto të fundit, ndryshe nga ne, kanë agjenci dhe institute të veçanta biznesi, kulturore dhe artistike edhe në Bruksel.

Natyrisht, ka ndihmuar shumë këto vitet e fundit përbërja e Përfaqësimit me 100 për qind me diplomatë karriere, profesionistë dhe të përkushtuar, ku mbizotëron dukshëm gjinia femërore.

Por, shembujt e lartpërmendur nuk janë as të vetmit dhe as të fundit në këtë katalog të pasur kulturor. Një vit më parë, flamuri ynë kombëtar u ngrit për herë të parë mes këngësh e vallesh në këtë të shenjë dalluese të Brukselit, Atomiumit të famshëm. Po atë ditë, për të tretin vit radhazi, Manekin Pis, statuja simbol e Brukselit që ndodhet në zemër të tij u vesh me kostumin tradicional shqiptar dhe tani është pjesë e muzeut të tij.

Këto dy ngjarje i paraprinë pranisë për herë të parë të Tiranës vitin e kaluar si mysafire nderi në "Panairin e Kënaqësive të Dimrit", më i madhi që zhvillohet prej dekadash në Bruksel. Ajo u organizua me nismën e kryebashkiakut Erion Veliaj, bashkëpunimit me Bashkinë e Brukselit, mbështetjes së deputetit Ahmet Gjanaj dhe komunitetit shqiptar. Për mbi një muaj, qytetarët belgë dhe të huaj e jo vetëm shqiptarë dëgjuan, panë dhe shijuan perla të muzikës sonë të bukur popullore të interpretuar nga këngëtarë të njohur dhe grupe muzikore nga të gjitha trevat e vendit, të shoqëruara me pijet dhe kulinarinë e pasur shqiptare, vlerat dhe atraksionet tona turistike, etj.

Këto veprimtari ishin prelude më i bukur dhe me jehonë për lancimin e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, ku krahas përkujtimit të veprës së tij të pavdekshme në mbrojtje të qytetërimit evropian, u ekspozuan edhe shumë vlera të kulturës tonë kombëtare. 10 shoqatat kulturore shqiptare zhvilluan veprimtari nga më të ndryshmet, promovime librash, çelje ekspozitash,

koncerte, shfaqje teatrore dhe recitime etj.. "Qershiza mbi tortë" ishte ansambli artistik i Shoqatës "Vatra" me valltarë/ë të talentuara që i japin dritë dhe ngjyra të bukura çdo feste dhe veprimtari në Bruksel dhe gjatë. Natyrisht që ky vit filloi atje, të statuja e Heroit tonë Kombëtar në Komunën Schaerbeek, për të cilin ambasada në bashkëpunim me komunën ishin kujdesur më parë për rehabilitimin dhe rinovimin e tij. Për të vijuar me aktivitetet shkencore dhe tematike që kulmojnë me mbremjen shkencore kushtuar Heroit tonë Kombëtar në qytetin e Namurit në fund të shtatorit. Aty ligjëruan njohës të kësaj figure, si publicisti Safet Kryemadhi dhe veterani 88-vjeçar Lek Perviz. Ky i fundit, me revistën e tij "Kuq e Zi", në nëntor festuan 25-vjetorin e krijimit dhe numrin e saj jubilar të 130. Vështrë të këtë revistë tjetër që të këtë botuar për 12 muaj rresht 100 shkrime, krijime, poezi, kujtime dhe foto mbi Skënderbeun.

Viti jubilar u pasqyrua denjësisht edhe në edicionin e 12 të festivalet më të madh kulturor të rajonit tonë në Bruksel, "Ballkan Trafik" më muajin prill. Veç të tjerash, aty jehoi kënga, vallja dhe talenti i artistëve të Ansambllit tonë të Këngëve dhe Valleve Popullore e sidomos e interpretuesit emblematik të polifonisë, Hysni Zela.

Duke e vlerësuar këtë veprimtari, më e madhja e këtij lloji në Evropë kushtuar Ballkanit, por kur "gjeografia" e tij është zgjeruar me grupe nga SHBA, India etj., me gjithë vështrësitë e mëdha, sidomos financiare, ambasada jonë me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës ka meritën se nuk e ka ndërprerë asnjë vit praninë në këtë festë të kulturës. Vlerë e shtuar është se grupet tona pjesëmarrëse janë të ftuara nderi në Manifestimin e Madh Popullor muzikor, në sheshin më të famshëm të Evropës, "Grande Place".

Drejtori i përgjithshëm, Nicolas Wierős, dashamirës i vendit tonë, që ka mbështetur edhe financiarisht grupet tona, ka planë dhe projekte të tjera për ta çuar këtë festival dhe aty në "sofrën ballkanike", duke filluar nga Tirana. Në gusht, ai ishte edhe në Gjirokastër, ku pati shumë takime me drejtues të qarkut, artistë, etnologë, pik-

torë, etj. Ai ka shprehur me kohë zyrtarisht dëshirën të takohet në Tiranë me drejtuesit e lartë të Ministrisë së Kulturës dhe është ende në pritje.

Veç kësaj, krahas metropoleve të tjera, sidomos Parisi, Berlini, Londra, Roma, ka ardhur koha që të vlerësohet shumë më tepër prania jonë kulturore, artistike, kinematografike etj., në Bruksel. Jo vetëm se aty janë institucionet e BE-së, NATO-s dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, por edhe përfaqësuesit e komunitetit botëror mediatik dhe kulturor me rrezatim planetar. Brukseli është kthyer në qendrën më të madhe politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, gastronomike etj. Ndaj, thuhet shpesh se "Brukseli është vendi ku duhet të jesh" dhe "në rast se do të dëgjohesh, eja në Bruksel".

Gjithsesi, me gjithë këtë bilanc të pasur, ndihet nevoja e shtimit të tyre për të përballuar sfidat e imazhit dhe për ta kthyer në konstante të përhershme diplomacinë kulturore. Duke mirëkuptuar kufizimet financiare të MPJ-së, ajo sërisht mund të kontribuojë më shumë duke konkretizuar marrëveshjet që ka nënshkruar me Dhomën e Tregtisë dhe firma të ndryshme, të cilat mund të lehtësonin edhe barrën financiare si pengesa kryesore në këtë fushë, siç veprojnë vendet e tjera të rajonit. Sot prirja është bashkëpunimi efektiv ndërmjet diplomacisë ekonomike dhe kulturore, në një sinergji aktive. Misionet ekonomike belge psh., vetëm emrin kanë të tillë, në fakt ato janë në radhë të parë misione kulturore, artistike, kulinare dhe pastaj tregtare.

Për një efektivitet më të madh të diplomacisë kulturore, është e nevojshme që Ministria e Kulturës të tregojë kujdes më të madh për një planifikim më të hershëm të fondeve për aktivitetet jashtë vendit e sidomos në Bruksel. Duke qenë diplomat deri para dy vitesh në këtë ambasadë, por mesa di edhe përfaqësitë e tjera, Ministrisë së Kulturës i dërgohen me kohë datat e sakta, programi dhe fondet minimale që kërkohen për veprimtari madhore që përsëriten, madje me tarifa minimale, ku ndonjëherë kërkohen vetëm navllot e udhëtimit, si në rastin e festivaleve kinematografike. Kështu janë mundësitë që të shmangen vonasat dhe veprimet e minutave të fundit me partnerët e huaj, të cilat jo vetëm zbehin cilësinë, por dhe rrezikojnë praninë tonë në këto veprimtari.

Së fundi, megjithëse si Ministria e Jashtme dhe ajo e Kulturës në përgjithësi janë treguar bashkëpunuese, sipas shembullit të vendeve të tjera, për mënjanimin e defekteve dhe mungesave në këtë fushë mund të ndihmonte edhe krijimi i një Komiteti Ndërqeveritar të Diplomacisë Kulturore, i përbërë nga përfaqësues të kulturës, arteve, diplomacisë, agjencive ekonomike etj.

HOROSKOPI

DASHI
Mos kërkonti gjëra të pamundur në dashuri, sepse rrezikoni të mbeteni vetëm. Në planin financiar situata do jetë e ekuilibruar.

DEMI
Ashtu si në ëndrra, situata romantike do jetë e mbushur me surpriza emocionale. Planetët do ndikojnë pozitivisht te financat tuaja.

BINJAKET
Siguria është ajo për të cilën keni më shumë nevojë, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë emocional. Sa i përket aspektit ekonomik, gjërat nuk po shkojnë sipas pritshmërive.

GAFORJA
Jeni me shumë fat që rrethohen nga njerëz pozitivë. Personat që nuk janë në një lidhje, do mund të bëjnë takime interesante sot. Me financat tregoni kujdes.

LUANI
Përballë problemeve me të cilat përballemi, keni afër njerëz që ju ndihmojnë. Njeriu juaj i zemrës do të jetë aty gjithmonë për ju.

VIrgJERESHA
Mos lejoni ndjesinë e plogështisë që t'ju pengojë në përditshmërinë tuaj. Financat nuk do jenë të këqija, nëse nuk e teproni me shpenzimet.

PESHORJA
Është më mirë që të përballemi me të vërteta të hidhura sesa me gënjeshtër të bukura. Financat do vijnë duke u përmirësuar në mënyrë të ndjeshme.

AKREPI
Për beqarët nuk do jetë aspak një ditë me fat, prandaj më mirë të mos marrin vendime sot për të ardhmen. Shmangni një debat me partnerin.

SHIGJETARI
Kushtojni më shumë vëmendje interesave tuaja. Mos i lini pas dore aktivitetet që i keni pasion. Në dashuri tregohuni më besnik.

BRICJAPI
Ju mungon qetësia shpirtërore këto ditë. Merrni më shumë kohë për veten tuaj. Një vrap në natyrë mund ta ndryshojë gjendjen tuaj emocionale.

UJORI
Problemet në çift mund të zgjidhen falë një komunikimi të qetë. E rëndësishme është që të mos lini pas dore bashkëbisedimin me partnerin.

PESHQIT
Mund të krijoni një lidhje të qëndrueshme falë aspektit planetar të favorshëm. Edhe situata financiare parashikohet të jetë shumë pozitive.

Intervista e Ditës

"Bisedat e rralla me Bush", Berisha flet për mikun e shqiptarëve

Ish-presidenti i ndjerë Xhorxh Bush kishte jo pak miq edhe në Shqipëri dhe sapodalë nga diktatura komuniste në fillim të viteve '90. Më i spikatur i midis tyre është ish-Presidenti i Shqipërisë, Sali Berisha, i cili kujton me detaje bisedat me zotin Bush për Kosovën, Shqipërinë si dhe forcimin e demokracisë dhe paqes në rajon.

INTERVISTA E PLOTË

... që e keni takuar gjithë nga fillimi i pluralizmit shqiptar, në fillim të viteve '90. Çfarë menduat atë moment dhe si e përjetuar lajmin për ndarjen nga jeta të presidentit Bush?

Sali Berisha: Për mua, lajmi për ndarjen nga jeta i presidentit Bush ishte një lajm i hidhur, i trishtuar. Presidenti Xhorxh Bush ka qenë politikani, me të cilin unë kam pasur marrëdhëniet më miqësore gjatë gjithë karrierës sime politike. Gjysh nga dy muajt e parë të mandatit tim si President i Shqipërisë, nga pranvera e 1992 e deri pak muajsh, unë kam ruajtur një komunikim të vazhdueshëm me të. Kam pasur fatin e madh, privilegjin e veçantë të gëzoj miqësinë e tij. Ky është një lajm shumë i hidhur dhe i trishtuar.

Zëri i Amerikës: Çfarë kujtoni nga takimi i parë me presidentin Bush?

Sali Berisha: Nga takimi i parë me presidentin Bush, përshytyja më e madhe ishte thjeshtësia dhe cilën ai më priti. Xhorxh Bush në të vërtetë i përkiste pa diskutim fshikërisë më të lartë të kohës, por nga ana tjetër, ai ishte edhe njeriu më tëkësor që mund të takojë në qarqet politike amerikane dhe botërore. Ftesa dhe pritja në Dhomën Ovale ishte një moment historik për jetën time, por brenda pak çastesh gjithçka u bë shumë e thjeshtë në komunikim. Presidenti Bush filloi bisedën me Kosovën. Ajo që më bëri shumë përshytyje, por që edhe ishte problemi më kryesor. Ai u ngrit, mori një atlas në zyrën e tij, e hapi atlasin dhe u ulëm e folëm për Kosovën. Më pyeti: Çfarë mendon? Unë i shpjegova, e i thashë se plani i Milosheviçit është spastrimi etnik i Kosovës dhe ndarja e saj.

Në atë kohë plani i Milosheviçit për ndarjen e Kosovës i binte mes për mes Prishtinës, e kishte pak më të madh planin se sa e kanë këta sot Milosheviçit e rinj. I thashë zotit Bush se Milosheviç synon që zindra e mijëra shqiptarë që janë banorë në zonat e tyre prej mijëra vitesh t'i shpërngulë, t'i sjellë në pjesën tjetër dhe pastaj thotë le të bëjnë çfarë të duan. Le të bashkohen me Shqipërinë ose le të bëjnë tjetër çfarë të duan. - Por kjo, i thashë unë, krijon luftë. - Pse, tha, krijon luftë? - Ne, i thashë unë, nuk e sulmojmë Jugosllavinë, por nëse Milosheviç e ndërmerri një plan të tillë, kufi më nuk do të ketë. Ndaj dua të jem i sinqertë; edhe nëse dëshiroj të parandaloj një konflikt në shkallë të gjerë midis shqiptarëve dhe serbëve, nuk do të mund ta parandaloj atë.

As nuk mund ta ndërmarri një gjë të tillë, përkundrazi, unë do të hap kufirin dhe do të bëj gjithçka që ata njerëz të qendrojnë në shtëpitë e tyre. - Right point, më tha Bush. - Ke të drejtë, është çështje e



drejtë. Mënyra se si e parashtrua me vërtetësi çështja u pranua nga presidenti Bush. Pas kësaj ai luajti një rol kapital në bllokimin e këtij plani, pasi në dhjetor ai i dërgoi një ultimatum Milosheviçit me një të dërguar special, ku ia qartësoi që në rast se ti zbristë ushtritë në Kosovë (sepse korparmatën e kishte në Nish dhe ishte bërë gati të zbriste), ti do të përballesh me bombardimin me të gjitha llojet e armëve amerikane, përveç atyre të shkatërrimit në masë, përveç armëve nukleare. Në të vërtetë Milosheviç nuk e lëvizi ushtrinë.

Zëri i Amerikës: Po për rajonin më gjerë?

Sali Berisha: Përveç Kosovës, një vendim morën SHBA-të edhe për Maqedoninë, ...sepse Maqedonia fillimisht nuk ishte bindëse, ndaj SHBA-të nuk e kanë njohur fillimisht Maqedoninë, por e njohën më vonë. SHBA-të bënë një gjë shumë të madhe: SHBA ndërhyjnë nëpërmjet OKB-së dhe shpalojnë dy batalione ushtarësh; një batalion ushtarësh amerikanë në flamarinin e OKB-së dhe një batalion tjetër me ushtarë të vendeve nordike. Milosheviç fillimisht besonte se e ka në xhep Maqedoninë dhe e kishte këtë plan, por SHBA-të ia dështuan këtë plan. Ishin SHBA-të dhe mençuria e Presidentit Gligorov bënë që Maqedonia të mbetet, si mos sulmohet e të ndahet paqësisht nga federata jugosllave.

Në atë periudhë kam lobuar me sa kam pasur mundësi, të mos lejohet Milosheviç të zbrisë në Maqedoni dhe të krijojë një konflikt në Maqedoni, i cili do të ishte më i tmerrshëm se sa konfliktet në veri. Interesi i administratës së presidentit Bush për rajonin ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm. Amerikanët po studionin, siç ma kishte thënë Igëllberger, nëse rajoni ka apo jo interes strategjik për SHBA-të për paqen, sepse SHBA-të gjithnjë kanë përparësi ruajtjen e paqes dhe promovimin e demokracisë në botë.

SHBA-të konkluduan që rajoni është i një rëndësie strategjike për SHBA-të dhe u angazhuan. Presidenti Bush është arkitekt i kësaj politike të vazhduar pastaj nga presidenti Klinton, i cili e rimori në mënyrë eksplicite pas inaugurimit vijën e kuqe të hequr ndaj Milosheviçit, mbajti qëndrim shumë të qarta për papërkrahshmërinë e Maqedonisë. U bë kështu një kuader i rëndësishëm ndërko-

mbëtar, i cili pengoi përhapjen e luftës në Jugun e Ballkanit.

Zëri i Amerikës: Zoti Berisha, çfarë keni biseduar me presidentin Bush në këto takime të para në fillim të viteve 90 lidhur me mbarrëvajtjen e demokracisë së re shqiptare pas gati gjysmë shekulli diktature komuniste?

Sali Berisha: Pas pritjes së parë në Shtëpinë unë pata edhe shumë takime me presidentin Bush. Në këto takime presidenti Bush ishte mjaft i habitur dhe ndjente keqardhje të thellë për atë që kishin pësuar shqiptarët gjatë diktaturës. Një nga aktet e tij ishte kur na dha klauzolën e kombit me të favorizuar në tregti. Përtej eksporteve të papërfillshme të Shqipërisë, ai ishte një gjest inkurajues shumë miqësor që të ngjallte optimizëm.

Ndërkohë, temat kryesore kishin të bënin me demokracinë. Mes të tjerash, ai më kishte treguar se si në kohën kur ishte ambasador në Kinë zoti Bush në pritje diplomatike përpiqej të komunikonte edhe me ambasadorin shqiptar, i cili çuditërisht i largohet dhe nuk pranonte të komunikonte me të. Si dërgues i agjencisë së informacionit ai kishte njohuri të gjera për Shqipërinë, sepse përbente shembullin më të zi të pasojave të një diktature e të një regjimi. Interesimi i tij ishte i madh dhe mbështetja e tij politike kishte rëndësi shumë të madhe.

Zëri i Amerikës: Zoti Berisha, çfarë ndihmese mendoni ju se ka dhënë presidenti Bush në fillimin dhe më tej në fuqizimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane në shumë fusha?

Sali Berisha: Presidenti Bush ka vendosur themelet e reja në marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve. Në atë periudhë ka pasur një dialog shumë intensiv midis qeverisë shqiptare dhe qeverisë së SHBA-ve për të gjitha zhvillimet në rajon. U krijuan bazat e një bashkëpunimi shumë të mirë në shumë fusha, midis tyre edhe në fushën e sigurisë.

Të mos harrojmë se dronët e parë në Europë janë vendosur në Gjadrë. Ato ishin dronë, të cilat mbikëqyrnin me një precizion, fotografonin me një precizion shumë të madh të gjitha zhvillimet në luftën e Bosnjës dhe i transmetonin në kohë reale në qendrimin e tyre. Pra, atë kohë dhe më vonë u vendos një bashkëpunim sensitiv

në fushën e sigurisë, ushtrisë e në të gjithë fushat.

Zëri i Amerikës: A kujtoni ndonjë detaj të veçantë nga takimi që keni pasur më vonë në Vlorë me Presidentin Bush dhe me sekretarin Powell?

Sali Berisha: Para se të vinte në Vlorë, ai erdhi në Tiranë. Presidenti Bush, si ish-president ka ardhur dy herë në Shqipëri. Në të dy herët ai ka ardhur në mbështetje të demokracisë shqiptare. Në vizitën e tij në Tiranë unë e kam akorduar Medaljen e Lirisë, në atë kohë ishte titulli më i lartë. Pastaj më ftoi në Texas, dhe unë shkova në Hjuston, mik i tij në familje. Edhe unë e ftova të vijë prapë. Ai erdhi në Vlorë me të gjithë dinastinë Bush, përveç Xhorxh W. dhe me sekretarin Powell.

Kjo ishte një vizitë miqësore, ishte një udhëtim turistik me jahtin Alexander. Ndalimi në Vlorë ishte një gjest miqësor ndaj Shqipërisë dhe ndaj meje. Unë e njoha atë me të gjithë zhvillimet dhe problemet që përballje Shqipëria. Unë mund të them se kam pasur gjithnjë mbështetjen e tij. Edhe ajo vizitë synonte një mbështetje, pasi ai kishte besim tek unë në bisedat dhe në paraqitjen që unë u bëja problemeve.

Zëri i Amerikës: Shumë njerëz besojnë se presidenti Bush erdhi në Vlorë të bisedonte me ju për zhvillimet e brendshme të Shqipërisë.

Sali Berisha: Pa diskutim që edhe ato ishin dhe ai erdhi për të shprehur mbështetje ndaj Sali Berishës. Kjo është e vërteta. Erdhi me të gjithë familjen dhe me sekretarin Powell në vilën e Vlorës. Pastaj ai shtroi një darkë në jahtin Alexander, ku ishin Xhef Bush dhe djemtë e tjerë, përveç Xhorxh W. Kaluam një pasditë dhe një darkë të paharrueshme në Vlorë dhe në jahtin me të cilin ata erdhën.

Zëri i Amerikës: Zoti Berisha, përmendet pak më parë fshikëria e presidentit Bush dhe miqësinë e tij me presidentin Klinton më pas. Çfarë mund të mësojë politika shqiptare nga fshikëria e presidentit Bush dhe bashkëpunimi i tij me demokratët? Politikanët shqiptarë janë shumë agresivë, guja e tyre është shumë e ashpër. Si mund të përfitojë politika shqiptare nga kjo përvojë e presidentit Bush?

Sali Berisha: Mendësi tjetër ajo e politikanëve amerikanë. Kurse

këtu dominon një mendësi fundamentaliste. Konstatohet letë se të gjithë qëndrimet e sotme bëjnë gjithçka që të nxijnë me çdo gjë të dëshmen dhe përpiqen të paraqesin se gjithçka fillon me ta. Kjo të rikujton historinë e vjetër të udhëheqjes shqiptare që bënte çdo gjë për të demonizuar mbretërinë, në mënyrë që të mos kishin referencë. Faktikisht këtë mentalitet e trashëgon sot edhe kjo maxhorancë me në krye Edi Ramën. Nuk ndërtohet duke mohuar. Në radhë të parë duhet të ndërtohet. Mënyra më e mirë për të folur është se duhet të flasësh me vepra. Por sot nuk flitet me vepra.

Zëri i Amerikës: Si mund të dalë Shqipëria dhe politika e saj nga kjo vorbull e nihilizmit dhe e mohimit të rezultateve të pararendësve dhe si mund të bëhet politika më të dobishëm për qytetarët?

Sali Berisha: Pavarësisht nga momentet e acarta që kanë ekzistuar në marrëdhëniet midis forcave të mëdha politike, e vërteta është që konstantja e tyre ka qenë bashkëpunimi. Kjo sot nuk është kuptuar nga Edi Rama, që bashkëpunimi midis forcave të mëdha politike është jetik, por që të bashkëpunojë qeveria me opozitën kjo ka një kusht themelor: Qeveria detyrimisht duhet të ndiejë domosdoshmërinë e këtij bashkëpunimi. Kjo qeveri nuk e ndjen këtë domosdoshmëri.

Zëri i Amerikës: Për shkak të numrave në parlament?

Sali Berisha: Në radhë të parë për shkak të mendësisë. Le të krahasojmë dy periudha: në periudhën 2007 unë kisha votat dhe nuk kisha shtërngicë për numra. Por për të ecur drejt NATO-s pa opozitën nuk ecur dot. Një ditë më erdhi në zyrë Marsi Ris, ambasadorja amerikane dhe më thotë: - Zoti Berisha ka shumë kohë që nuk bëni më politikë. I them: - Zonja ambasador, ashtu është, por qëllimi im kryesor është të realizohet ajo vizitë e presidentit Bush në Shqipëri dhe nuk doja që të kish të shërre midis, përkundrazi doja që atë ta përjetonim të gjithë si një ngjarje të madhe.

Zëri i Amerikës: Ndërsa sot...?

Sali Berisha: Sot kreu i maxhorancës bën gjithçka për të denigruar për të kufizuar për të demonizuar opozitën. Ai nuk ndjen nevojën, ai nuk kupton se është pikërisht kjo betejë e tij që bëri që Shqipëria të humbasë dy herë trenin e BE-së: një herë në 2016 duke mos hapur negociatat, dhe në 2018 të mos hapë negociatat sërish. Ai fajëson opozitën, duke thënë se "është opozita që trillon dhe përçjell tek të tjerët, tek ndërkombeëtarët, një situatë që nuk ekziston në Shqipëri". Në të vërtetë është ai që nuk percepton realitetin shqiptar ashtu si është.

Ka një problem madhor Shqipëria për të gjithë partnerët ndërkombëtarë nga Uashingtoni e me radhë: Krimi i organizuar, i cili gjendet kudo në botë. Në Shqipëri ai është në kulme, por Shqipëria ka një kryeministër, që është i vetmi në botë që thotë se në Shqipëri nuk kemi banda, kemi keqëbërës, por banda nuk kemi(!). Ky shembull tregon se ku gjendet Rama në raport me realitetin shqiptar. Edhe opozita për të nuk ka asnjë vlerë dhe duhet vetëm denigruar/VOA/

TRAJNERI I FRANCËS

Deshamp: Me Shqipërinë kemi hasur vështirësi në të shkuarën

Trajneri i Francës, Didier Deshamp, ka cilësuar të vështirë grupin në të cilin Franca bën pjesë së bashku me Shqipërinë, Islandën e Turqinë. "Është një grup, ai që është. Shqipërinë e njohim, pasi jemi përballur disa herë. Më vjen mirë që përballim me

Panuçin, pasi njihemi. E njoh mirë si lojtar kur isha te Monako. Tani presim kalendarin për të ditur se kur luajmë. Kemi hasur vështirësi me Shqipërinë dhe kam respekt të madh për këtë skuadër. Shumë lojtarë po luajnë mirë me klubet e tyre. Duhet përqendrim dhe kujdes për të parë të gjitha

detajet. Është shumë e vështirë, por ajo që është e sigurt është që Islanda me rezultatet në Francë ka bërë shumë mirë dhe do të jetë kaq e fortë apo jo nuk e dimë. Turqia është e fortë, por edhe Shqipëria. Nuk i veçojmë dot, por në fushë do të kemi ndeshje të vështira", u shpreh Deshamp

TRAJNERI I TURQISË

Luçesku: Franca rivali ynë, ndaj Shqipërisë s'do jetë e lehtë

Trajneri i Turqisë, Mircea Luçesku, foli pas shortit në grup me Shqipërinë, Francën, Islandën, Moldavinë dhe Andorrën, ku u shpreh: "Sigurisht, me Francën nuk është e lehtë. Do doja që të mos e luanim ndeshjen e parë kundër tyre. Ne do të futemi në fushë për të fituar.

Shpresoj që ekipi ynë i ri të tregojë një performancë të mirë. Na duhen patjetër fitore me Moldavinë dhe Andorrën. Ndaj Islandës kemi avantazhin që e njohim dhe lojtarët e tyre nuk kanë ndryshuar shumë. Nuk kanë më atë performancë si në Botëror

dy vite më parë. Ne kemi formuar një skuadër të re në 7 muaj. Po rinovojmë ekipin, nga gabimet individuale. Shqipëria gjithashtu është një skuadër e mirë. Tashmë do të jetë një atmosferë ndryshe në një kompeticion të ri", - deklaroi Mircea Luçesku.

Me Islandën, Moldavinë dhe Andorrën, kuqezinjtë do të kërkojnë një nga dy biletat për në European



Jeton Selimi

Shqipëria, në grup me Francën dhe Turqinë

Panuçi: Mund të shkonte më keq se kaq

Është hedhur dje në Dublin të Irlandës shorti për kualifikueset e "Europianit 2020". Mund të konsiderohet një short pa fat për kuqezinjtë e Shqipërisë, duke qenë se goglat i kanë rezervuar kundërshtarë relativisht të vështirë në letër. Shqipëria, që bënte pjesë në vazon e katërt në këtë short, është shortuar për eliminatoret e "Euro 2020" në grupin H, aty ku janë edhe 5 skuadra të tjera. Së bashku me Shqipërinë në grup, janë edhe Franca, Islanda, Turqia, Moldavia dhe Andorra. Në fakt mund të kishte dhe short më të lehtë për kuqezinjtë, ashtu siç mund të kishte edhe shumë më të vështirë se ky. Kujtojmë që ndaj Turqisë, Shqipëria e Panuçit ka luajtur në një ndeshje miqësore ku edhe ka fituar, ndërkohë që tani është prova e vërtetë për



tanët, në ndeshje zyrtare. Panuçi e sheh gotën gjysmë plot Trajneri i Kombëtares, Kristian Panuçi ka komentuar shortin e Europianit,

EURO 2020	
GRUPI H	GRUPI A
Francë	Angli
Islandë	Çeki
Turqi	Bullgari
Shqipëri	Mali i Zi
Moldavi	Kosovë
Andorrë	

duke u shprehur se mund të kishte edhe më keq, ndërkohë që ka pranuar se skuadra do të luftojë për vendin e dytë. "Mund të shkonte më mirë, por edhe më keq, gjithsesi e pranojmë se mund të bëhemi gati për të bërë më të pamundurën. Franca është favoritja e madhe, pastaj janë Turqia e Islan-

da, dy skuadra të forta, të cilat janë për vendin e dytë. Gjëja më e rëndësishme është të rikuperoj të gjithë lojtarët, se juve në Shqipëri nuk ju intereson për lojtarët, por për rezultat. Po nuk pata lojtarët, nuk mund të bëj rezultat. Ne duhet të shkruajmë historinë tonë dhe të bëjmë një arritje të madhe. Shpresojmë të jenë të gatshëm dhe të kemi mundësi të zgjedhim mes shumë lojtarësh dhe të mos jemi të detyruar të bëjmë zgjedhje të sforcuara. Me të gjithë në dispozicion e shoh të luftojmë me Islandën e Turqinë dhe mundohet për të arritur e dyta, se Franca është favorite", u shpreh Panuçi.

TRAJNERI I KOSOVËS

Shaland: Jemi në grup të fortë, por nuk duam të ndalemi

Kosova do të luajë në Grupin A, me Anglin, Malin e Zi, Çekinë e Bullgarinë, raporton. "Dardanët" mund të jetë e kënaqur me shortin, duke marrë parasysh se ka mundur të ketë kundërshtarë më të fortë se ekipet që pati fat t'i ketë në grup. Në ndryshim nga Anglia dhe Çekia që shihen si kundërshtarë më të fortë, Kosova pritet ta ketë më të lehtë ndaj Bullgarisë dhe Malit të Zi dhe mund të shpresojë për një kualifikim në "Euro 2020". Njeriu që e udhëhoqi Kosovën drejt një fushate shumë të suksesshme në Ligën e Ko-



mbeve, duke e promovuar nga Liga D në Ligën C dhe duke i siguruar një vend në "play-off për kualifikime në "Euro 2020", Bernar

Shaland, ka besim se verdhkaltrit mund t'ia dalin edhe këtu. "Nuk është grup i lehtë, por ne jemi Kosova. Nuk mund të mendojmë se jemi në një grup të lehtë, pasi Anglia është skuadër shumë e fortë dhe këtë e dimë. Por me skuadrat e tjera është e mundur, kam besim në ekipin tim, i cili është shumë mirë para ndeshjes me Maqedoninë". Në "Euro 2020" do të kualifikohen dy ekipet e para nga secili prej 10 grupeve. Fushata e kualifikimeve nis në ndeshjet e para, më 21 dhe 23 mars të vitit 2019.

KATEGORIA SUPERIORE


Laçi e Kamza ndahen në paqe, Kastrioti thyen Flamurtarin

Laçi dhe Kamza u ndanë në një barazim pa gola, në sfidën e javës së 15-të në Kategorinë Superiore. Sfidat e luajtur në stadiumin e kurbinasve pati shumë pak raste, për të pretenduar 3 pikët. Pjesa e parë pa vetëm një rast të Boninit me kokë, ndërsa më shumë pati përplasjet të ashpra në mesin e fushës. E dyta nisi me Kamzën më kërkuese, por nuk shfrytëzoi dot rastet me Plakun. Mersinaj provoi në momentet e fundit të lojës me kokë, por Avdyli kontrolloi gjithçka me duar dhe, edhe lëvizjet e të dy teknikëve, Memelli dhe Gjoka nuk sollën ndonjë realizim. Në fund 0-0, dhe të dyja ekipet që ndajnë nga një

pikë. Kastrioti ka befasuar Flamurtarin, duke e mundur me rezultat in ngushë 1-0 në takimin e vlefshëm për javën e 15 të Kategorisë Superiore. Goli i shënuar nga Okebuku në pjesën e parë ka mjaftuar për krutanët që të marrin 3 pikëshin e tretë në këtë sezon, duke i afruar tashmë Tiranës, pasi diferenca është vetëm 1 pikë. Me këtë fitore të arritur, Kastrioti i largohet vendit të fundit, duke ia kaluar Kamzës dhe tashmë ka hyrë në lojë seriozisht për mbijetesë. Nga ana tjetër, Flamurtari renditet në vendin e 6, në kuotën e 22 pikëve.

SUPERLIGA		
TE PREMTEN		
Partizani - Tirana		2-1
TE SHITJENEN		
Lufitëari - Kukësi		0-1
Skënderbeu - Teuta		0-1
TE DIELEN		
Laçi - Kamza		0-0
Kastrioti - Flamurtari		1-0
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	15	34
Skënderbeu	15	30
Teuta	15	28
Kukësi	15	27
Laçi	15	26
Flamurtari	15	22
Lufitëari	15	13
Tirana	15	11
Kastrioti	15	10
Kamza	15	9

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë intensive ne shumë barna.
8. Inicialet e Basinger aktore.
10. Alkajq aktore.
13. Eshhtë edhe ai tretës.
14. Ishte muza e astronomisë.
16. Një është për të lidhur.
17. U hodhën ngë Tartar nga Zeusi.
19. Diku në qendër.
20. Gjysmë tatimi.
22. Janë shemra.
25. Janë pallto ushtarësh.
27. Fillojnë titrat.
28. Një garë e gjatë.
30. Janë në modë.
32. Qarkullon në SHBA.
33. Një pjesë elementare.
35. Mund të jetë e shkencave dhe ushtarake.
38. I famshmi Pacino.
40. Inicialet e Morricone-s.
41. Eshhtë edhe ai i Zi.

42. Me të bëjnë tortë.
43. Vanessa violiniste.
45. Ishte lumi i harresës.
46. Një pjesë e nergjive.
47. Një markë makine amerikane.
50. I famshëm ai i mjelmave.
53. Shkruhet në korrik.
54. Janë si zakone

VERTIKAL

1. Ishte muz e komedisë.
2. Eshhtë shkrimi me kreshnikët
3. Rastet pa set.
4. Nuk i tregohen babait.
5. Nuk lejohet një i tillë në kthesë.
6. Në fund të fundit
7. Agjenci Informative italiane.
8. Mbushen me vota.
9. Eshhtë sekrete në derë.
10. Enti italian i energjisë elektrike.
11. Kujtohen me nostalgji ato të rinisë.
12. Dy asa.
15. France shkrimtar.
18. Janë tallës.
21. Eshhtë si baba.
23. Janë tituj në ekran.
24. Një konfuzion total
26. Lasgushi poet.
28. Ekstrete në minifund.
29. Role pa zë.
31. Mudoohen til largojnë ekzorçistët.
33. Luarasi aktore.
34. Mund të jetë pushimi.
36. U printe hunëve.
37. Grandi këngëtare.
39. Shteti me Vientiane.
44. Ente Ndërkombëtare Humanitare.
45. Pak latinisht.
46. Ente Qëndrore Ekonomike.
48. Kufizojnë trotualet.
49. Inicialet e Asimov.
51. Fillojnë ideologjinë.
52. Inicialet e Turgeniev.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një sportist në pistë.
5. Philippe në një markë ore.
9. Chris këngëtar.
10. Fillojnë aksionin.
12. Ato historike përkujtohen.
14. Një vit që parashikohet.
15. Janë shkronjat e mëdha.
17. Këndohet në opera.
18. Eshhtë shumë e brinjëve të katrorit.
20. Dhjetë angleze.
21. Këndohen poshtë ballkonit.
22. Mbyllin një studim.
23. Eshhtë shpend lagune.
24. Në radhë të parë.
26. Komisari... i Dritëro Agollit.
28. Eshhtë budallaqja.
30. Janë si vegla.
32. Mund të jenë autonome të tilla.

VERTIKAL


34. Një ushtarak i ulët.
36. Një shok armësh.
37. Grazia Cucinotta aktore.
39. U shkrua nga Zola.
41. Kapen të parat.
42. Një pjesë e tingullit.
43. Eshhtë thënie e famshme.
44. Një pjesë e parlamentit.
45. Mund të jetë çikistik
46. Fillojnë takimin.
47. Kërkojnë talent të tilla.
6. Ishin kapo kozakë.
7. Ishte filozof i Miletit.
8. Ndiqet nga e nënta.
11. Mund të jenë republike
12. Janë shtylla me vela
13. Kush ka do të hajë.
16. Përfshijnë edhe karotat.
19. Rotor pa zë.
21. Fillojnë sefte.
23. Eshhtë aru i bardhë.
25. Eshhtë libri i parë.
27. Një fjalë si tutje.
29. Një franceze.
31. Maria Remarque shkrimtar.
32. Tase e volejbolit.
33. Përplasen me gaitu.
35. Kusturica regjisor.
36. Panik pa kutji.
38. Zanonë për alibi
39. King Cole i muzikës.
40. Ai dhe ajo.
42. Në krytë të trupave.
44. Fillojnë profesionin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4	7	3		8				1
6		1	7	9	2			
				1		8		
	9				7	6	3	
2			4					
5		7			6			
	5		2	4				8
1		2						7
3			5		1			9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	1	6	2	3	8	5	7	9
5	3	8	7	4	9	1	6	2
2	7	9	5	1	6	3	4	8
6	8	1	3	2	7	9	5	4
7	9	4	8	5	1	2	3	6
3	5	2	9	6	4	7	8	1
9	6	3	4	7	2	8	1	5
1	2	5	6	8	3	4	9	7
8	4	7	1	9	5	6	2	3

Argëtim filozofik

-Dikush mund të pretendojë se ka zemër, por jo shpirt.

-Çdo e vërtetë kalon nëpër tre faza: në fillim e sulmojnë duke e paraqitur atë si marrëzi, atëherë e pranojnë se është ndoshta e saktë por e parëndësishme. Përfundimisht e njohin rëndësinë e saj dhe pastaj ish-kundërshtarët fillojnë të pretendojnë nderin e kampionit.

-Një grua hyn në jetën tuaj. Kjo është e mrekullueshme. Del nga ajo. Eshhtë një dhuratë hynore.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	7	1	11		11	10		7	9	5	14	7	H	A	R	E	M	P	A	G	F	A	T			
19	2		13	4		1	7	15	7	14	7	4	E	R	I	K	D	A	R	T	A	K	A			
15		10	7	1	5	6	12	5	13		13	7	N	A	M	P	E	R	I	M	E	T	E	R		
	12	5	8	2	11	4	5		2	12	7	4	D	T	G	E	N	E	U	N	O					
1	7	10	2	1	4	7				8	5		2	E	K	A	P	I	T	A	L	I	S	T	E	
	16	7	1	7		13		13	5	1	13		K	E	E	P	R	I	L	S	R	P				
10	2	1	7	4		4	1	19	13	7	4		E	E	M	A	O	K	A	T	E	I				
5	19	5				14	6	14	13	1	2		T	E	B	A	R	B	O	R	B	O	R	E	G	T
1	14				10	2	1	5	9	7	4		15	T	F	O	R	D	E	M	I	L	T	E		
6	14			4	5	4	2	8	7		5	14	2	H	A	R	I	E	N	I	I	N	A	T		
16	7			19	6	5	4	7	4		18	6	1	A	L	E	A	T	E	K	A	M	A	R	E	
2		13	1	2	9	7	1			16	2	4	5	T	L	T	B	E	N	E	S	A	I	T		

Thënie të mençura

- Pas rënies së Murit të Berlinit, kuptuam se çdo gjë që na u tha për socializmin ishte një gënjeshtër dhe të gjitha ato që na thanë për kapitalizmin ishin të vërteta.
- Magjia e jetës është paparashikueshmëria e saj.
- Kur të tjerët të kuptojnë vlerën tënde të vërtetë...ti do të jesh me persona që tashmë e dinë!!!
- Nëse sot nuk bëj asgjë për ty, është sepse djë bëra gjithçka që mundat!!!

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

S	K	U	N	E	R	S	H	T	A	R	E	T
A	K	I	R	A	T	E	R	R	E	N	E	
R	A	M	F	K	M	E	R	I	T	A		
A	L	P	A	L	A	D	I	N	E	E	T	
H	E	M	A	T	O	M	A	S	E	T	E	R
M	I	N	A	R	E	T	E	T	D	E	R	
M	I	N	I	M	A	L	E	D	I	O	R	
A	A	N	A	I	R	O	M	M	E	L		
N	D	E	N	D	E	R	I	E	V	E		
D	E	O	A	T	I	A	I	I	U	N	A	H
A	R	R	A	T	I	A	I	I	U	N	A	H
T	R	I	O	N	G	J	A	R	J	A	R	
P	I	L	A	M	B	A	R	A	K	A	I	T
A	D	A	K	A	Z	A	N	E	T	R	A	
S	E	V	A	L	E	R	O	M	A	R		
A	T	A	P	O	L	I	F	E	M	I	I	
P	E	R	S	E	R	I	T	E	S	T	I	F
O	T	E	L	E	G	O	N	I	O	P	A	
R	R	E	Z	E	T	N	O	A	L	I		
T	R	O	T	M	N	O	T	O	R	I		
A	M	I	N	M	O	D	E	M	G	A	S	
T	A	L	A	R	N	E	N	E	J	T	E	
D	L	A	R	E	N	G	R	I	E	R		
K	E	N	E	T	A	T	K	A	M	A	T	E

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

